



QKSS
Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë


**KONRAD
ADENAUER
STIFTUNG**

SFIDAT DHE PRIORITETET E KOSOVËS NË FUSHËN E POLITIKËS SË JASHTME DHE TË SIGURISË

Aleatët



Aktorët Malinj



SFIDAT DHE PRIORITETET E KOSOVËS NË FUSHËN E POLITIKËS SË JASHTME DHE TË SIGURISË

PUBLIKUAR NGA:

© Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS)

© Konrad-Adenauer-Stiftung (KAS)

AUTORË:

Ramadan Ilazi



Ramadan Ilazi aktualisht shërben si Kryesues i Hulumtimeve pranë Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS). Dani ka PhD në Politikë dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare nga Shkolla e Drejtësisë dhe Qeverisjes së Dublin City University (DCU), Irlandë, dhe master në studime të konfliktit dhe paqes në Universitetin St. Andrews, Skoci, si bursist i Chevening. Dani është hulumtues për Programin e Evropës Juglindore të Fondacionit Grek për Politikë Evropiane dhe të Jashtme (ELIAMEP) dhe anëtar i Task Forcës për Kërcënimet ndaj Demokracisë në Ballkanin Perëndimor pranë Institutit Republikan Ndërkombëtar. Më parë, Dani ka mbajtur pozitën e zëvendësministrit të Kosovës për Integritet Evropiane (2015-2016), ku ka qenë i përfshirë në mbështetjen e procesit të përgatitjes së një plani kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit me Bashkimin Evropian dhe zhvillimin e Agjendës së Reformave Evropiane (ARE) për Kosovën. Libri i tij më i fundit është “Bashkimi Evropian dhe Shtetndërtimi i Përditshëm: Rasti i Kosovës” (Routledge 2022).

MIRËNJOHJE:

Autori dëshiron të falënderojë Asllan Zenunajn për kontributin e tij në këtë raport.

DIZAJNI DHE PARAQITJA NGA:

Brand Vision Shpk

Kontakti: +383 45 559 923

Email: brandvision.rks@gmail.com

© **Mohim i përgjegjësisë:** Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument janë të autorit dhe nuk paraqesin medoemos pikëpamjet e Konrad-Adenauer-Stiftung. Ky botim i Konrad-Adenauer-Stiftung shërben vetëm për qëllime informative. Ai nuk mund të përdoret nga partitë politike ose nga aktivistët apo mbështetësit zgjedhorë për qëllime të reklamës zgjedhore.

Përmbajtja

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
2. HYRJE	7
3. VENDOSJA E KONTEKSTIT PËRMES GJURIMIT TË PROCESIVE RRETH ZHVILLIMEVE KRYESORE TË LIDHURA ME SIGURINË DHE POLITIKËN E JASHTME NGA VITI 2021 DERI NË VITIN 2025	8
4. KONTEKSTI STRATEGJIK	14
5. SFIDAT KRYESORE TË POLITIKËS SË SIGURISË DHE TË JASHTME TË KOSOVËS	17
5.1. Sfidat e sigurisë	17
5.2. Sfidat e politikës së jashtme	20
6. ÇKA DUHET TË PRIORITIZOJË KOSOVA NË POLITIKËN E SAJ TË JASHTME DHE TË SIGURISË	23
7. KONKLUZIONE	29

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Viteve të fundit, ngjarjet në veriun e Kosovës me shumicë serbe dhe tensionet e vazhdueshme me Serbinë kanë luajtur rol madhor në formësimin e politikës së jashtme dhe sigurisë së vendit. Këto çështje u kthyen në thelbin e pozitës ndërkombëtare të Kosovës, duke ndikuar në përparimin e saj drejt integritimit në BE, marrëdhëniet me NATO-n, qasjen në organizatat ndërkombëtare, sigurinë e brendshme dhe reputacionin e vendit. Dy zhvillime madhore patën një ndikim të thellë në sigurinë e brendshme dhe politikën e jashtme të Kosovës. E para është sulmi terrorist në Banjskë. Shërbimi Evropian i Veprimit të Jashtëm (EEAS), përmes një deklarate të Përfaqësuesit të Lartë Josep Borrell, e dënoi shprehimisht sulmin në Banjskë si një *“sullm qyqar dhe burracak terrorist kundër zyrtarëve të Policisë së Kosovës”*, duke bërë thirrje që autorët të dorëzohen dhe të sillen para drejtësisë.¹ Pothuajse një vit pas sulmit, Prokuroria Speciale e Kosovës e cilësoi zyrtarisht sulmin në Banjskë si akt terrorizmi, duke ngritur aktakuzë kundër 45 individëve, përfshirë Milan Radoiçiqin, për akuza që lidhen me organizimin dhe drejtimin e aktiviteteve terroriste, krime kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Kosovës, financim të terrorizmit dhe pastrim të parave.²

Zhvillimi i dytë ishte shpërthimi i 29 nëntorit 2024 që e dëmtoi rëndë kanalin e ujit Ibër-Lepenc pranë fshatit Varragë në komunën e Zubin Potokut, në veri të Kosovës. Pjesë e infrastrukturës kritike, ky kanal furnizon me ujë të pijshëm disa komuna dhe siguron ujin e domosdoshëm për ftohje për objektet kryesore të prodhimit të energjisë elektrike në Kosovë. Sipas Prokurorisë Speciale të Kosovës, në kanal u vendosën dhe shpërthyen rreth 20 kilogramë eksploziv (TNT), duke shkaktuar dëme të konsiderueshme strukturore, ndërprerje të furnizimit me ujë dhe duke rrezikuar përkohësisht prodhimin e energjisë elektrike. Në dhjetor 2025,

Prokuroria Speciale e Kosovës ngriti aktakuzë kundër tre individëve për veprat penale të “rrezikimit të rendit kushtetues me shkatërrimin apo dëmtimin e instalimeve dhe pajisjeve publike, “kryerjes së veprës terroriste”, “armëmbajtjes pa leje” dhe “spiunazhit”.³

Ky ndryshim u bë më i qartë kur shpërthimi në kanalin Ibër-Lepenc në nëntor 2024 nxori në pah cenueshmërinë e infrastrukturës kritike dhe riskun e përshkallëzimit përtej trazirave publike. Prokuroria Speciale e Kosovës më vonë ngriti aktakuzë kundër tre të dyshuarve me akuza që përfshijnë kryerjen e një akti terrorist, spiunazh dhe armëmbajtje pa leje. Sipas prokurorisë janë përdorur eksplozivë të konsiderueshëm dhe shkaktuar ndikime konkrete si ndërprerja e furnizimit me ujë të pijshëm dhe rrezikimi i infrastrukturës energjetike. Sulmi në kanal përforcoi ndjenjën, veçanërisht në Bruksel, se veriu i Kosovës nuk ishte vetëm i kontestuar politikisht, por edhe i infiltruar nga akterë të gatshëm të shënjestrojnë infrastrukturën strategjike. Në kontekstin më të gjerë rajonal, ku shpesh debatohen orientimi i sigurisë i Serbisë, narrativat dhe rreshtimet e jashtme, ky incident i shtoi peshë argumentit se Kosova u përball me taktika hibride dhe shtrënguese dhe jo vetëm me dinamika të protestave qytetare. Edhe kur partnerët iu shmangën mbështetjes së argumenteve të Kosovës për atribuímin, natyra e veprës – sabotimi i infrastrukturës jetike – ishte e vështirë të minimizohej.

Këto zhvillime i ndryshuan realitetet në terren në Veri duke e zbehur funksionin de-facto të sigurisë të ushtruar nga figura të tilla si Radoiçiqi dhe rrjetet e ndërlidhura. Banjska ekspozoi një zinxhir të armatosur koordinimi dhe justifikoi një qasje më të fortë ndaj zbatimit të ligjit dhe sigurisë në komunat veriore. Kjo ishte e vërtetë si në këndvështrimin e Kosovës ashtu edhe në mesin

1 Shërbimi Evropian i Veprimit të Jashtëm (EEAS), “Kosovë: Përfaqësuesi i Lartë Borrell flet me Kryeministrin Kurti dhe Presidentin Vuçiq pas sulmit ndaj Policisë së Kosovës”, 24 shtator 2023, https://www.eeas.europa.eu/eeas/kosovo-high-representative-borrell-speaks-prime-minister-kurti-and-president-vu%C4%8Di%C4%87-following-attack_en

2 Radio Evropa e Lirë (RFE), “Kosova ngre aktakuzë kundër 45 individëve për rolet e supozuara në sulmin e vitit 2023 që vrau zyrtarin policor”, 11 shtator 2024, <https://www.rferl.org/a/kosovo-indicts-banjska-attack-suspects-radoicic/33116016.html>

3 Balkan Insight (BIRN), “Kosova ngre aktakuzë kundër tre individëve për shpërthimin në kanal në nëntor 2024”, 9 dhjetor 2025, <https://balkaninsight.com/2025/12/09/kosovo-indicts-three-for-november-2024-canal-explosion/bi/>

e disa hisedarëve ndërkombëtarë. Kombinimi i etiketimit si terrorist në nivel të BE-së dhe aktakuza e prokurorisë për vepra të lidhura me terrorizmin e bënë më pak të besueshëm trajtimin e këtyre rrjeteve si thjesht ndërmjetës politikë. Në vend të këtij lloj trajtimi, ky kombinim e theksoi rolin e tyre si kontrollorë joformalë të sigurisë – akterë të aftë të organizojnë dhunë, të pengojnë qasjen institucionale dhe të formësojnë qeverisjen e përditshme përmes frikësimit. Në këtë kuptim, Banjska nuk e ndryshoi vetëm retorikën. Kjo ngjarje e përshpejtoi ndryshimin e trajtimit të Veriut nga një problem i menaxhimit politik në një problem autoriteti shtetëror dhe sigurie, duke ua ngushtuar hapësirën rojtarëve të armatosur për të vepruar me pandëshkueshmëri.

Sulmi në Banjskë në shtator 2023 shënoi një pikë kthese në nivelin e perceptimit të dinamikës së sigurisë në veri të Kosovës nga komuniteti ndërkombëtar. Kjo kishte rëndësi sepse kontribuoi në pranimin më të qartë mes partnerëve kyç të Kosovës se veriu nuk ishte vetëm sfidë e qeverisjes dhe pranimi të autoritetit të shtetit të Kosovës, por edhe problem i rëndë i sigurisë. Së bashku, Banjska dhe sulmi në kanal in e ujit në Zubin Potok ndihmuan në zhvendosjen e narrativës së jashtme rreth asaj që po bënte qeveria e Kosovës në veri. Nga një narrativë që shpesh i shqyrtonte vendimet ose veprimet e Kosovës në lidhje me veriun kryesisht si të rënda, ajo kaloi në pranim më të hapur të pranisë e akterëve shtrëngues që sfidojnë monopolin e forcës që mban shteti.

Në të njëjtën kohë, mjedisi post-Banjskë nuk prodhoi mbështetje të pakushtëzuar perëndimore për të gjitha veprimet e qeverisë së Kosovës në Veri. Edhe pse Banjska (dhe më vonë shpërthimi në kanal) e rriti mirëkuptimin për shqetësimet e sigurisë së Kosovës dhe forcoi legjitimitetin e perceptuar të disa veprimeve zbatuese, BE-ja dhe SHBA-ja i perceptuan disa veprime si të pa koordinuara mjaftueshëm, joproporcionale ose politikisht përshkallëzuese. Kjo rrugë e dyfishtë, me pranim më të madhe të shqetësimeve të sigurisë së Kosovës nga njëra anë, por kritika të vazhdueshme për zbatim “të rëndë” nga ana tjetër, në një farë mase ndihmon në shpjegimin pse Kosova mund të fitojë besueshmëri në pretendimin themelor

(se rrjetet shtrënguese në veri ishin një shqetësim me interes jetik për Kosovën) ndërkohë që ende përballet me kosto politike për zgjedhje specifike në kohë, komunikim dhe konsultim me partnerët për disa masa të tjera që cak kanë institucionet serbe në veri. Me fjalë të tjera, sulmi terrorist në Banjskë e rriti legjitimitetin e Kosovës për të vepruar në Veri, por nuk i hoqi pritjet se si duhet të veprojë Kosova.

Për shkak të atyre që BE-ja i perceptoi si veprime të pakoordinuara dhe përshkallëzuese nga qeveria e Kosovës në Veri, në qershor 2023 BE-ja prezantoi masa kufizuese të përkohshme dhe të kthyeshme kundër vendit.⁴ Shtetet e Bashkuara pezulluan Dialogun Strategjik të planifikuar në shtator të vitit 2025 “për shkak të shqetësimeve për veprimet e qeverisë kujdestare që kanë rritur tensionet dhe paqëndrueshmërinë”.⁵ Këto zhvillime negative krijuan sfida për objektivat e sigurisë dhe politikës së jashtme të Kosovës.

Nga fundi i vitit 2025 dhe fillimi i vitit 2026, BE-ja e ndryshoi qasjen e saj, duke reflektuar për kufijtë e masave ndëshkuese të zgjata dhe duke pranuar se izolimi pa afat i Kosovës ishte kundërproduktiv. Në mars 2026, Komisioni Evropian njoftoi zyrtarisht heqjen e të gjitha masave ndëshkuese të BE-së kundër Kosovës, pas angazhimit produktiv të qeverisë për trajtimin e zbatimit të Ligjit për të Huajt në veri të Kosovës.⁶ Heqja e masave ishte padyshim një pranim se teksa veprimet e Kosovës në veri ishin shpesh të rënda dhe të koordinuara dobët, konteksti më i gjerë i sigurisë dhe rezultati i zgjedhjeve të parakohshme të dhjetorit 2025, të cilat i dhanë partisë në pushtet të kryeministrit Kurti 51%, kërkonin ri-angazhim.

Synimi kryesor i politikës së jashtme të Kosovës është avancimi i integritetit në komunitetin euroatlantik. Për sa i përket progresit, në pesë vitet e fundit këtu u përfshi liberalizimi i vizave në vitin 2024, aplikimi për anëtarësim në BE në vitin 2022 dhe qasja në Planin e Rritjes së BE-së dhe Instrumentin për Reforma dhe Rritje. NATO gjithashtu luan një rol kyç të sigurisë përmes KFOR-it dhe mbështetjes së vazhdueshme nga Ekipi Këshillimor dhe Ndërlidhës i NATO-s dhe kornizës së zgjeruar të ndërveprimit. Në dosjen NATO-Kosovë ndoshta zhvillimi më i rëndësishëm ishte pjesëmarrja në stërvitjen “Defender Europe 25”

4 Lexoni më shumë në: <https://legalpoliticalstudies.org/wp-content/uploads/2024/06/EI022024-GLPSEI-The-One-Year-Anniversary-of-EU-Measures-against-Kosova-1.pdf>

5 Lexoni më shumë në: https://xk.usembassy.gov/st_9122025/

6 Lexoni më shumë në: <https://europeanwesternbalkans.com/2026/03/18/kosovo-leaders-welcome-lifting-of-all-eu-punitive-measures/>

të udhëhequr nga NATO, me Forcën e Sigurisë së Kosovës që kontribuoi me rreth 1,000 efektivë dhe ishte mikpritëse e stërvitjes. Stërvitja u zhvillua nga 26 maji deri më 9 qershor 2025 së bashku me 28 vende partnere.⁷

Kosova ndërmori disa hapa për të ngritur një politikë më të fortë dhe më të pavarur të sigurisë, veçanërisht përmes rritjes së buxhetit për mbrojtjen dhe njoftimit të partneritetit me prodhuesin shtetëror të mbrojtjes MKE për të ndërtuar objektin e prodhimit të municioneve në Kosovë. Qeveria gjithashtu publikoi dokumente kyçe si Strategjia e Sigurisë së Kosovës 2022-2027⁸ dhe Strategjia Kombëtare për Sigurinë Kibernetike 2023-2027⁹.

Përparimi në njohjen ndërkombëtare të Kosovës ishte i ngadaltë, por nuk ka ngecur. Izraeli vendosi marrëdhënie diplomatike me Kosovën në vitin 2021 pas marrëveshjes së Uashingtonit dhe Kenia e njohu Kosovën në vitin 2025, duke shënuar njohjen e parë të madhe në gati pesë vjet. Më pas erdhën njohjet nga Sudani, Siria dhe Bahamas. Kosova gjithashtu aplikoi për anëtarësim në Këshillin e Evropës në vitin 2022¹⁰, megjithëse ky proces është i lidhur me hapat e Kosovës për themelimin e Asociacionit të Komunave me shumicë serbe (Asociacioni).¹¹ Kosova gjithashtu forcoi bashkëpunimin e saj të sigurisë me BE-në, përmes krijimit të aranzhimeve punuese me EUROPOL-in.¹²

7 Lexoni më shumë në: <https://a2news.com/english/rajoni-bota/kosova/aktualitet/truri-i-operacionit-ne-gjakove-ushtria-e-kosoves-t-1149015>

8 Lexoni më shumë në: <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/10/2-Strategjia-e-Sigurise-e-Kosoves-ENG.pdf>

9 Lexoni më shumë në: <https://mpb.rks-gov.net/Uploads/Documents/Pdf/EN/2692/Strategjia%20për%20Siguri%20Kibernetike%20-%20ENG..pdf>

10 Lexoni më shumë në: <https://rm.coe.int/application-by-kosovo-for-membership-of-the-council-of-europe-/1680af1575>

11 Lexoni më shumë në: <https://www.esiweb.org/proposals/admit-kosovo-council-europe#:~:text=This%20is%20probably%20why%2083,France%2C%20Germany%20and%20Italy>

12 Lexoni më shumë në: <https://www.europol.europa.eu/partners-collaboration/agreements/kosovo>

2. HYRJJE

Nga viti 2021 deri në vitin 2025, politika e jashtme dhe e sigurisë e Kosovës kishte një strategji të qartë, por u përball me sfida në rritje. Vendi mbeti i përkushtuar në rrugën e tij euroatlantike, mbështeti Perëndimin në çështjet kyçe dhe vazhdoi të punonte drejt njohjes, anëtarësimit në NATO dhe BE, si dhe drejt marrjes së një roli më të madh në sigurinë dhe diplomacinë ndërkombëtare. Megjithatë, kjo periudhë tregoi se sa lehtë mund të ngecë përparimi kur dalin pengesa nga krizat në veriun me shumicë serbe të Kosovës, tensionet e vazhdueshme me Serbinë, koordinimi i dobët me aleatët dhe mjedisi global në ndryshim. Në realitet, problemet me agjendën e Kosovës kishin më pak të bënin me mungesën e synimeve sesa me vështirësitë për t'i realizuar ato në mënyrë konsistente dhe praktike.

Ky raport shqyrton sfidat kryesore të jashtme dhe të sigurisë së Kosovës dhe thekson disa prioritetet të mundshme për politikën e ardhshme. Ai përdor një përzierje të analizës së dokumenteve, gjurmimit të procesit dhe intervistave me informues kyç. Analiza e dokumenteve mbulon të dhënat e qeverisë, raportet e BE-së dhe NATO-s, deklaratat, dokumentet e politikave dhe burime të tjera përkatëse. Gjurmimi i proceseve ndjek ngjarjet kryesore nga viti 2021 deri në vitin 2025, të tilla si krizat në veri, progresi i bisedimeve për normalizim të udhëhequra nga BE-ja, ndryshimet në marrëdhëniet me aleatët e rëndësishëm dhe hapat e Kosovës drejt integritimit evropian dhe ndërkombëtar. Intervistat me zyrtarë të lartë, si aktualë ashtu edhe të mëparshëm, ofrojnë njohuri për dobësitë, shanset e humbura dhe vendimet strategjike të Kosovës.

Argumenti kryesor i këtij raporti është se sfida më e

madhe e Kosovës në aspektin e politikës së jashtme dhe të sigurisë nuk është zgjedhja e një drejtimi. Strategjia dhe orientimi i vendit janë të qarta. Problemi i vërtetë është kthimi i kësaj strategjie në rezultate të dobishme për interesat jetike kombëtare të Kosovës, të cilat mund të përfshijnë stabilitetin dhe integritimin e veriut të vendit, perspektivën reale për anëtarësim në NATO dhe BE, normalizimin e plotë të marrëdhënieve me Serbinë, mbajtjen e lidhjeve të forta me Shtetet e Bashkuara dhe bërjen e institucioneve më reziliente ndaj krimit, kërcënimeve kibernetike, dezinformimit dhe presionit të jashtëm. Në vazhdim, politika e jashtme dhe e sigurisë e Kosovës duhet të përqendrohet më pak në slogane si prioritetet e politikës së jashtme dhe të sigurisë dhe më shumë në planifikim më të mirë të brendshëm, koordinim më të fortë me aleatët, si dhe duke u bërë një partner i besueshëm dhe i parashikueshëm.

Ky raport ka katër seksione kryesore. Së pari, vlerësohet si ka ndryshuar politika e jashtme dhe e sigurisë së Kosovës viteve të fundit, veçanërisht me ndryshimet në mjedisin rajonal dhe ndërkombëtar. Më pas, shqyrtohen sfidat kryesore me të cilat përballet Kosova, siç janë zhvillimet në veri, procesi i normalizimit me Serbinë, marrëdhëniet me partnerët kyç perëndimorë dhe ndikimi në rritje i kërcënimeve hibride, pasigurisë kibernetike dhe ndikimit të huaj. Seksioni i tretë përshkruan prioritetet kryesore të Kosovës për të ardhmen e afërt, duke u fokusuar në ngritjen e reziliencës së brendshme dhe forcimin e lidhjeve me NATO-n, BE-në, organizatat ndërkombëtare dhe partnerët e tjerë. Për fundi, raporti i bashkon këto pika dhe sugjeron se detyra kryesore e Kosovës tani është t'i vërë në veprim planet e saj strategjike në një mënyrë më konsistente dhe më të besueshme.

3. VENDOSJA E KONTEKSTIT PËRMES GJURMIMIT TË PROCESIVE RRETH ZHVILLIMEVE KRYESORE TË LIDHURA ME SIGURINË DHE POLITIKËN E JASHTME NGA VITI 2021 DERI NË VITIN 2025

Nga viti 2020 deri në vitin 2025, storja e Kosovës ndoqi dy rrugë kryesore. Së pari, pati disa hapa të rëndësishëm drejt integritit euroatlantik, si aplikimi formal për anëtarësim në BE në vitin 2022, liberalizimi i vizave më në fund në vitin 2024 dhe përditësimi i statusit në Asamblenë Parlamentare të NATO-s (AP e NATO-s) nga statusi i vëzhguesit në anëtar të asociuar në vitin 2024. Së dyti, pati kriza të përsëritura në veri të vendit, të cilat tensionuan resurset politike, çuan në përgjigje më të rrepta nga partnerët kyç (BE dhe SHBA) dhe zbuluan disa dobësi në reziliencën e sigurisë së Kosovës.

Në vitin 2020 u nënshkruan marrëveshjet e normalizimit ekonomik ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, të referuara zakonisht si Marrëveshja e Uashingtonit.¹³ Kjo përbëhej nga dy dokumente të veçanta përmes të cilave të dyja palët u angazhuan për avancimin e bashkëpunimit ekonomik. Marrëveshjet u nënshkruan nga kryeministri i Kosovës Avdullah Hoti dhe presidenti i Serbisë Aleksandar Vuçiq në Shtëpinë e Bardhë, në prani të presidentit të atëhershëm amerikan Donald Trump. Si pjesë e marrëveshjes, Izraeli e njohu pavarësinë e Kosovës. Një zhvillim i madh për Kosovën në vitin 2020 ishte vendosja e aranzhimit punues me Europol-in, çka krijoi një kornizë formale për bashkëpunim ndërmjet institucioneve të Kosovës dhe agjencisë ligjzbatuese të BE-së.¹⁴ Marrëveshja shënoi një hap të rëndësishëm në forcimin e angazhimit të Kosovës me strukturat

evropiane të sigurisë, duke mundësuar shkëmbimin e strukturuar të informacionit dhe bashkëpunimin në fusha të tilla si krimi i rëndë dhe i organizuar, terrorizmi dhe kërcënimet e tjera të lidhura me sigurinë.

Kosova dhe Izraeli vendosën zyrtarisht marrëdhënie diplomatike në shkurt 2021, me Kosovën që u pajtua ta hapë ambasadën në Jerusalem.¹⁵ Kjo lëvizje tërhoqi vëmendjen për Kosovën, nga aleatët e saj kryesorë. Turqia reagoi zyrtarisht duke e dënuar ashpër lëvizjen. Në një deklaratë të lëshuar nga Ministria e Punëve të Jashtme turke, Ankaraja e përshkroi vendimin si në kundërshtim me rezolutat përkatëse të Kombeve të Bashkuara për statusin e Jerusalemit dhe argumentoi se minon zgjidhjen me dy shtete dhe perspektivat për paqe në rajon.¹⁶

Në shtator të vitit 2022, tensionet mes Kosovës dhe Serbisë u përshkallëzuan pas vendimit të Kosovës për të zbatuar rregulloret reciproke për targa të automjeteve, duke kërkuar që automjetet që përdorin targa të lëshuara nga Serbia të kalojnë në targa të lëshuara nga Kosova.¹⁷ Masa, e paraqitur nga institucionet e Kosovës si vendosje e sundimit të ligjit dhe reciprocitetit, u kundërshtua fuqishëm nga Beogradi dhe serbët e Kosovës në veri, duke çuar në protesta, bllokime të rrugëve në pikat kyçe kufitare dhe dislokime të shtuara të sigurisë nga policia e Kosovës dhe misioni KFOR i NATO-s. Deri në dhjetor 2022, tensionet u

13 Lexoni më shumë në: <https://peacemaker.un.org/en/node/10069>

14 Lexoni më shumë në: <https://www.europol.europa.eu/partners-collaboration/agreements/kosovo>

15 Lexoni më shumë në: <https://www.theguardian.com/world/2021/mar/14/kosovo-opens-embassy-in-jerusalem-after-israel-recognises-its-independence>

16 Lexoni më shumë në: <https://www.dailysabah.com/politics/diplomacy/turkey-strongly-condemns-kosovos-embassy-in-jerusalem>

17 Lexoni më shumë në: <https://www.rferl.org/a/kosovo-tensions-serbia-license-border/32015648.html>

përshkallëzuan, u ngritën barrkada dhe Serbia i kërkoi leje NATO-s për të dislokuar deri në 1,000 trupa në Kosovë.¹⁸ Kosova dhe Serbia arritën një marrëveshje të ndërmjetësuar nga BE-ja në nëntor 2022 për de-eskalim të kontestit rreth targave të automjeteve.¹⁹ Sipas marrëveshjes, Serbia u pajtua të ndalë lëshimin e targave me emra të qyteteve të Kosovës, ndërsa Kosova pezulloi masat e mëtejshme në lidhje me ri-regjistrimin e detyruar të automjeteve. Marrëveshja u prezantua nga BE-ja si një hap konkret drejt lehtësimit të tensioneve dhe përmirësimit të lirisë së lëvizjes. Duke u bazuar në këtë, **në janar 2024 BE-ja njoftoi se kontesti për targat ishte mbyllur formalisht**, me të dyja palët që u pajtuan t'i njohin reciprokisht targat e njëra-tjetrës, duke e shfuqizuar plotësisht regjimin e përkohshëm të stikerëve.²⁰ BE-ja e përshkroi këtë si një masë të rëndësishme për ngritjen e besimit në kuadër të dialogut të lehtësuar nga BE-ja.

Në fillim të vitit 2023, BE-ja e bëri Marrëveshjen për Rrugën drejt Normalizimit fokusin kryesor të bisedimeve, duke vijuar me **Aneksin e Zbatimit të Ohrit** në muajin mars. Teksa BE-ja më vonë e formalizoi këtë si propozimin e vet, në fakt fillesat i ka si **iniciativë franko-gjermane** në vjeshtën e vitit 2022, kur Berlioni dhe Parisi u përpoqën t'i rifillonin diskutimet e ngecura.²¹ Shumë analistë theksuan se propozimi bazohej në Traktatin Bazë të vitit 1972 midis Gjermanisë Lindore dhe Perëndimore.²² Kjo nuk kërkonte njohje formale reciproke, por synonte normalizimin e marrëdhënieve duke bërë që secila palë të pranonte institucionet dhe rolet ndërkombëtare të tjetrës në praktikë. Pra, në vend që të ishte një ide e re e BE-së, propozimi ishte një përpjekje e rinovuar diplomatike gjermano-franceze që të 27 vendet anëtare të BE-së e mbështetën më vonë.

Mbështetësit e Marrëveshjes për Rrugën drejt Normalizimit të Marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë besonin se ishte përpjekja më serioze ndër vite për t'i çuar bisedimet përtej menaxhimit afatshkurtër të krizave dhe drejt normalizimit të qëndrueshëm. Megjithatë, kritikët thanë se plani

nuk zgjidhte çështjet kyçe politike, veçanërisht në lidhje me rendin e hapave, mënyrën e zbatimit të tyre dhe statusin e serbëve të Kosovës në veri.²³ Edhe para takimeve në Bruksel dhe Ohër, Albin Kurti tha se propozimi franko-gjerman ishte pikënisja e duhur dhe bëri thirrje që ai të diskutohet menjëherë.²⁴

Megjithatë, ngjarjet në terren shpejt treguan disa nga dobësitë e marrëveshjes. Në maj 2023, tensionet u rritën shpejt pasi marrjes së detyrës së kryetarëve të komunave nga shqiptarë etnikë në zonat me shumicë serbe, pas zgjedhjeve që u bojkotuan nga serbët e Kosovës. Përleshjet në veri plagosën rreth 25 deri në 30 trupa të KFOR-it, shtynë NATO-n të dërgonte më shumë forca dhe sollën thirrje të reja nga grupet ndërkombëtare për de-eskalim të menjëhershëm dhe koordinim më të mirë me KFOR-in dhe EULEX-in. NATO më vonë tha se viti 2023 solli aq dhunë sa u deshën deri në 1,000 trupa shtesë, rritja më e madhe e forcave të KFOR-it në dhjetë vjet. Për shkak të përshkallëzimit të situatës në Kosovë dhe asaj që BE-ja e pa si mungesë koordinimi nga qeveria për veprimet e ndërmarra në veri, në qershor BE-ja vendosi masa të përkohshme dhe të kthyeshme kundër Kosovës, duke thënë se ato do të hiqeshin nëse do të kishte hapa të vërtetë për të lehtësuar tensionet në veri. Këto ngjarje nxorën në pah problemin kryesor me procesin e vitit 2023, për faktin se edhe pse Marrëveshja për Rrugën drejt Normalizimit shihej si një hap i madh përpara, zbatimi i saj ndodhi në një mjedis ku Serbia vazhdoi të sfidonte të drejtën e Kosovës për të ekzistuar si shtet. Në vend që të shënonte një fazë të re të normalizimit, viti 2023 shënoi kthim të rëndë prapa në marrëdhëniet Kosovë-Serbi, duke u përshkallëzuar në sulmin terrorist të shtatorit 2023 në Banjaskë në veri të Kosovës.

Në janar 2024 hyri në fuqi liberalizimi i vizave për qytetarët e Kosovës, çka shënoi rezultatin e parë dhe më serioz të prekshëm të procesit të integritimit evropian për kosovarët dhe ndihmoi ndjeshëm në uljen e izolimit të Kosovës. Megjithatë, kjo solli edhe

18 Lexoni më shumë në: <https://www.reuters.com/world/europe/serbia-request-permission-deploy-its-troops-kosovo-2022-12-15/>

19 Lexoni më shumë në: <https://www.politico.eu/article/kosovo-and-serbia-reach-european-solution-on-number-plate-dispute/>

20 Lexoni më shumë në: <https://www.eunews.it/en/2024/01/08/end-of-the-license-plate-row-between-serbia-and-kosovo-after-two-and-a-half-years-thanks-to-eu-mediation/>

21 Lexoni më shumë në: [https://www.europarl.europa.eu/thinktank/en/document/EPRS_BRI\(2025\)779231](https://www.europarl.europa.eu/thinktank/en/document/EPRS_BRI(2025)779231)

22 Lexoni më shumë në: https://hiia.hu/wp-content/uploads/2023/07/mki_FPR_beliv_online_173-183_kreft.pdf

23 Lexoni më shumë në: <http://www.democratizationpolicy.org/why-the-german-french-initiative-on-kosovo-serbia-wont-add-up/>

24 Lexoni më shumë në: <https://www.balkanweb.com/en/albin-kurti-propozimi-franko-gjerman-te-vendoset-ne-tryeze-nje-ore-e-me-pare/#gsc.tab=0>

sfida të reja, si nevoja për të monitoruar kërkesat e rreme për azil, siç përmendet në raportin e Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2025. Në veri të Kosovës, kontestet për monedhën, ndër të tjera, u bënë më serioze. Reuters raportoi se Kosova kërkonte që pagesat të bëheshin vetëm në euro dhe zyrtarët përëndimorë paralajmëruan se kjo mund të rriste tensionet. Më vonë në vitin 2024, një sulm terrorist në infrastrukturën kritike të Kosovës dëmtoi kanalin e ujit Ibër-Lepenc në Zubin Potok në veri të Kosovës që furnizon me ujë termocentralet kryesore dhe ndikoi edhe në kapacitetin e ujësjellësit të Prishtinës.²⁵

Në vitin 2025, Kosova u përball me ngërç politik, lehtësim të kushtëzuar të masave të BE-së dhe përparim në njohjen ndërkombëtare, me katër shtete që e njohën Kosovën, Kenia (mars), Sudani (prill), Siria (tetor) dhe Bahamas (dhjetor). Njohja nga Kenia shënoi njohjen e parë pas gati pesë vjetësh pa përparim në këtë dimension të politikës së jashtme, që kur Izraeli e kishte njohur Kosovën në vitin 2021. Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2025 përshkruan një fushatë përçarëse para zgjedhjeve të rregullta që u mbajtën në shkurt të vitit 2025, dhe një periudhë ngërçi më pas, me një qeveri kujdestare.

TABELA 1: Disa nga zhvillimet madhore në periudhën 2020-2025 me relevancë të mundshme për politikën e jashtme dhe të sigurisë së Kosovës

Viti	Zhvillimet	Ndikimi në siguri / politikë të jashtme
2020	Zotimet e Uashingtonit për normalizimin ekonomik (ndërmjetësuar nga SHBA). Kosova dhe Serbia nënshkruan zotime të veçanta në Shtëpinë e Bardhë të fokusuar në normalizimin ekonomik dhe jo në kontestin themelor për statusin.	Aktivizoi kanalin diplomatik të udhëhequr nga SHBA-ja për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, por nuk e zgjidhi kontestin themelor politik. Për Kosovën, paketa prodhoi edhe efekte konkrete të politikës së jashtme, siç ishte njohja nga Izraeli.
2020	Hyn në fuqi aranzhimi punues me Europol-in. Aranzhimi me Europol-in hyri në fuqi më 27 korrik 2020.	Hap konkret drejt integritit funksional me strukturat evropiane të sigurisë. Përmirësoi bazën për bashkëpunim në fushat e krimit të organizuar, terrorizmit dhe shkëmbimit të informacionit, edhe pa status të plotë operacional.
2021	Formalizohen marrëdhëniet diplomatike Kosovë-Izrael. Marrëdhëniet diplomatike u vendosën formalisht më 1 shkurt 2021.	Rezultat i qartë për agjendën për njohjen e Kosovës. Në të njëjtën kohë, vendimi për hapjen e ambasadës në Jerusalem krijoi kundërshtime për politikën e jashtme më të gjerë të Kosovës dhe marrëdhëniet me partnerët kyç si Turqia.
2021	Kriza e targave në veri. Kontesti u përshkallëzua në protesta dhe bllokime të rrugëve para se të arrihej një aranzhim i përkohshëm i lehtësuar nga BE-ja, me KFOR-in që mori një rol të dukshëm stabilizues në pikat kufitare midis Kosovës dhe Serbisë.	Tregoi me sa shpejtësi mundën masat teknike të reciprocitetit të kthehen në çështje sigurie në veri. Riafirmoi edhe se KFOR-i mbetet stabilizuesi kryesor i jashtëm kur plasin tensione lokale.

25 Lexoni më shumë në: https://www.eeas.europa.eu/eeas/kosovo-statement-high-representative-water-canal-attack-zubin-potok_en

Viti	Zhvillimet	Ndikimi në siguri / politikë të jashtme
2022	Kontesti për dokumentet e identitetit shfryhet përmes lehtësimit të BE-së. Serbia u pajtua t'i shfuqizojë dokumentet e hyrjes/daljes për mbajtësit e letërnjoftimit të Kosovës dhe Kosova hoqi dorë nga planet për të imponuar të njëjtën kërkesë për mbajtësit e letërnjoftimeve të Serbisë.	Një shembull i dobishëm i menaxhimit të krizave nga BE-ja që funksionon siç është menduar. Tregoi se BE-ja kishte ende ndikim kur të dyja palët donin ta shmangnin një konfrontim të ri.
2022	Barrikada në veri dhe kërkesa drejtuar NATO-s nga Serbia për të dislokuar deri në 1,000 trupa të sigurisë në Kosovë. Beogradi i kërkoi zyrtarisht NATO-s të lejojë një dislokim të tillë gjatë krizës. ²⁶	Një nga pikat më të qarta të përshkallëzimit gjatë kësaj periudhe. Episodi nënvizoi se KFOR-i është rojtari i vërtetë për çështjet e vështira të sigurisë dhe se Serbia ishte e përgatitur t'i ngrinte tonet si me retorikë ashtu edhe institucionalisht.
2022	Kosova dorëzon aplikimin për anëtarësim në BE. Kosova e parashtroi aplikimin e saj në dhjetor 2022. ²⁷	Një lëvizje që u pa si taktike për ta shtyrë BE-në ta diskutojë këtë çështje dhe ta mbërthejë Kosovën më fort në procesin e anëtarësimit në BE.
2022	Kosova dorëzon aplikimin e saj në Këshillin e Evropës. Aplikimi u dorëzua më 12 maj 2022. ²⁸	Objektivi më realist i politikës së jashtme, i cili nuk u materializua për shkak se qeveria e Kosovës nuk i adresoi kushtet politike (të imponuara padrejtësisht më vonë) nga disa shtete anëtare të Këshillit të Evropës për ta dorëzuar draft statutin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës.
2023	Marrëveshja për Rrugën drejt Normalizimit ²⁹ dhe Aneksi i Zbatimit i Ohrit ³⁰ . BE-ja e ktheu nismën franko-gjermane në kornizën kryesore për dialogun dhe e ndërlidhi zbatimin me rrugët e të dyja palëve drejt BE-së.	Marrëveshja për rrugën drejt normalizimit ka rëndësi për politikën e jashtme dhe të sigurisë së Kosovës, sepse i çon marrëdhëniet Kosovë dhe Serbinë drejt njohjes de facto praktikisht. Sipas marrëveshjes, të dyja palët do të synojnë "marrëdhënie fqinjësore normale dhe të mira" të bazuara në të drejta të barabarta, do t'i njohin dokumentet dhe simbolet kombëtare të njëra-tjetrës, do t'i zgjidhin kontestet në mënyrë paqësore dhe do të shmangin kërcënimet ose përdorimin e forcës. Marrëveshja është veçanërisht e rëndësishme për Kosovën sepse ka paraparë se asnjëra palë nuk do ta përfaqësojë tjetrën ndërkombëtarisht dhe Serbia nuk do ta blloktojë Kosovën të anëtarësohet në asnjë organizatë ndërkombëtare.

26 Lexoni më shumë në: https://www.reuters.com/world/europe/serbia-request-permission-deploy-its-troops-kosovo-2022-12-15/?utm_source=chatgpt.com

27 Lexoni më shumë në: <https://www.reuters.com/world/europe/kosovo-submits-eu-membership-application-2022-12-15/>

28 Lexoni më shumë në: <https://rm.coe.int/application-by-kosovo-for-membership-of-the-council-of-europe-/1680af1575>

29 Lexoni më shumë në: https://www.eeas.europa.eu/eeas/belgrade-pristina-dialogue-agreement-path-normalisation-between-kosovo-and-serbia_en

30 Lexoni më shumë në: https://www.eeas.europa.eu/eeas/belgrade-pristina-dialogue-implementation-annex-agreement-path-normalisation-relations-between_en

Viti	Zhvillimet	Ndikimi në siguri / politikë të jashtme
2023	Kriza në veri të Kosovës, përplasjet me KFOR-in dhe masat e BE-së kundër Kosovës. Me të marrë shqiptarë të Kosovës detyrën e kryetarëve të komunave pas bojkotit serb të zgjedhjeve lokale, në trazirat që vijuan u plagosën trupa të KFOR-it dhe NATO dislokoi deri në 1,000 trupa shtesë, përforcimi më i madh në një dekadë, ndërsa BE-ja vendosi masa të përkohshme dhe të kthyeshme ndaj Kosovës.	Ky ishte viti kur trajtimi i veriut nga Kosova prodhoi kundërshtimin më të mprehtë nga BE-ja dhe SHBA-ja. Rezultati ishte një krizë sigurie dhe një kosto e prekshme politike në marrëdhëniet me SHBA-në dhe BE-në.
2023	Sulmi terrorist në Banjskë. Një grup i armatosur serb sulmoi Policinë e Kosovës në Banjskë më 24 shtator 2023, duke vrarë rreshterin e policisë Afrim Bunjaku. Sulmuesit më vonë u barrikaduan në kompleksin e manastirit.	
	Ky ishte incidenti më i rëndë i organizuar i sigurisë në Kosovë në vitet e fundit dhe tani kemi një situatë para dhe pas Banjskës në lidhje me marrëdhëniet Kosovë-Serbi, por edhe në përgjithësi se si perceptohet Serbia ndaj Kosovës. Sulmi tregoi se Kosova është e cenueshme prej sulmeve të jashtme të armatosura dhe e zhvendosi fokusin e diskutimeve në Kosovë në çështjet e sigurisë dhe jo në normalizim. Ai gjithashtu ngriti pikëpyetje në lidhje me besueshmërinë e aftësisë frenuese në veri të Kosovës, sepse nëse një grup i armatosur mund të organizojë një operacion të asaj shkalle nga Serbia, të hyjë në Kosovë dhe të përplasej me armë zjarri me Policinë e Kosovës, atëherë qëndrimi ekzistues i sigurisë nuk kishte qenë i mjaftueshëm për ta frenuar një inkursion të tillë. Vendimi i NATO-s pas sulmit për të autorizuar forca shtesë dhe për ta forcuar më tej praninë e KFOR-it, vetëm sa e nënvizoi këtë shqetësim. Qeveria e Kosovës u shpreh se sulmi terrorist në Banjskë nuk ishte një ngjarje lokale spontane, por një operacion i planifikuar i organizuar në Serbi. Në raportin e Ministrisë së Jashtme të Kosovës ³¹ thuhej se grupi i armatosur u nis nga Novi Pazari, hyri ilegalisht në Kosovë afër Izvorit dhe udhëhiqej nga Milan Radoičiqi. Raporti përmendi gjithashtu prova nga telefonat e sekuestruar, lidhjet me grupet e sigurisë dhe politikës serbe dhe armatimi që nuk përputhej me çka do të pritej nga një sulm lokal i improvizuar. Serbia e mohoi çdo lloj të përfshirjes shtetërore. Milan Radoičiqi e pranoi publikisht përgjegjësinë për organizimin dhe pjesëmarrjen në sulmin në Banjskë, megjithatë ai mbetet i lirë në Serbi.	
2024	Kontesti për zbatimin e pagesave vetëm në euro dhe heqjen e dinarit. Monedha formale e Kosovës është Euro dhe qeveria bëri lëvizje për ta zbatuar atë si e vetmja monedhë ligjore në veri ku dinari serb përdorej gjerësisht, dhe kjo shkaktoi kritika të forta nga BE-ja dhe SHBA-ja për shkak të efekteve në jetën e përditshme në zonat me shumicë serbe që varen nga pagesat dhe shërbimet e financuara nga Serbia.	Çështja nuk kishte të bënte vetëm me monedhën, pasi që sipas organizatave të shoqërisë civile në veri ndikonte në ofrimin e mirëqenies, arsimin, financimin e shëndetësisë dhe jetën e përditshme. Politikisht, kontesti përforcoi pikëpamjen midis partnerëve se qeveria e Kosovës po ndërmerr hapa pa koordinim të mjaftueshëm për çështje të ndjeshme të komunitetit.

31 Lexoni më shumë në: <https://prishtinainsight.com/kosovos-report-reveals-banjska-terrorist-attack-details-mag/>

Viti	Zhvillimet	Ndikimi në siguri / politikë të jashtme
2024	Sulm terrorist ndaj infrastrukturës kritike, përkatësisht kanalit Ibër-Lepenc, duke prekur furnizimin me ujë dhe prodhimin e energjisë elektrike. ³² Shpërthimi dëmtoi infrastrukturën që shërben për termocentralet kryesore të vendit dhe ndërpreu furnizimin me ujë, përfshirë në Prishtinë.	Përkujtesë serioze se infrastruktura kritike e Kosovës mbetet e cenushme prej sabotimit ose sulmeve të motivuara politikisht. Qeveria e Kosovës argumentoi se sulmi u krye nga "bandat e drejtuara nga Serbia", ³³ Sulmi kishte implikime të menjëhershme për sigurinë energjetike, shërbimet publike, ndër të tjera
2025	Kriza e zgjatur politike dhe zgjedhjet e përsëritura. Zgjedhjet e rregullta parlamentare u mbajtën në shkurt 2025, por nuk arritën të prodhonin një shumicë të qëndrueshme, duke rezultuar në vonesa të zgjatura për formimin e qeverisë. Kosova funksionoi për pjesën më të madhe të vitit nën një qeveri në detyrë dhe ngërçi përfundimisht rezultoi në zgjedhje të reja në dhjetor 2025. ³⁴	Viti 2025 u kthye në vit të humbur për Kosovën në aspektin e veprimtarive politike dhe politikave shtetërore. Qëndrimi i zgjatur i qeverisë në detyrë e ngadalësoi vendimmarrjen, dobësoi zbatimin e reformave dhe ndikoi drejtpërdrejt në aftësinë e Kosovës për t'i përmbushur zotimet sipas Planit të BE-së për Rritje, duke rezultuar në vonesa në qasje në fondet e BE-së. Kriza politike gjithashtu zvogëloi besueshmërinë e Kosovës tek partnerët e BE-së, kufizoi aftësinë e saj për t'u angazhuar në mënyrë proaktive në dialogun me Serbinë, si dhe e kufizoi planifikimin e politikës së jashtme dhe të sigurisë. Institucionet publike u ngulën në ngërçin e brendshëm, me kosto të prekshme për rrugën e integritit evropian të Kosovës. ³⁵
2025	Kenia e njeh Kosovën. Vendimi i Kenias në mars 2025 ishte njohja e parë e re në gati pesë vjet. ³⁶	E kufizuar sa i përket efektit praktik të menjëhershëm, por politikisht domethënëse.

32 Lexoni më shumë në: https://www.reuters.com/world/europe/explosion-damages-canal-feeding-power-plants-northern-kosovo-2024-11-29/?utm_source=chatgpt.com

33 Lexoni më shumë në: <https://www.dw.com/en/kosovo-claims-terrorist-act-after-power-plant-canal-blast/a-70925973>

34 Lexoni më shumë në: https://www.theguardian.com/world/2025/feb/10/kosovo-elections-ruling-vetevendosje-party-loses-majority-initial-results-show?utm_source=chatgpt.com

35 Lexoni më shumë në: https://www.europarl.europa.eu/doceo/document/AFET-PR-784231_EN.pdf

36 Lexoni më shumë në: https://www.reuters.com/world/europe/kenya-recognises-kosovo-independent-state-first-such-move-five-years-2025-03-26/?utm_source=chatgpt.com

4. KONTEKSTI STRATEGJIK

Nga viti 2020 deri në vitin 2025, politika e jashtme dhe e sigurisë e Kosovës funksionoi brenda një kornize strategjike të qartë, por të kufizuar. Aleatët jetikë të Kosovës janë Bashkimi Evropian (BE) dhe NATO/KFOR-i. Vendi u përball me sfida të vazhdueshme nga fushata e mosnjohjes nga Serbia, e cila shkeli marrëveshjet e lehtësuara nga BE-ja për normalizimin e marrëdhënieve dhe u përforcua nga Rusia dhe Kina në nivel ndërkombëtar. Përkundër këtyre kufizimeve, Kosova arriti disa rezultate konkrete. Marrëveshja e Stabilizim Asocimit mbeti në fuqi. Udhëtimi pa viza në zonën Schengen filloi më 1 janar 2024. Kosova aplikoi për anëtarësim në BE në dhjetor 2022 dhe u përfrua plotësisht me politikën e jashtme dhe të sigurisë së BE-së. Megjithatë, hendekët në zbatimin e reformave të lidhura me BE-në, krizat e përsëritura në veri dhe paraliza institucionale në vitin 2025 e dëmtuan besueshmërinë e Kosovës, kufizuan qasjen e saj në mjetet e BE-së dhe reduktuan fleksibilitetin e saj me partnerët kyç.

BE-ja ndikoi në mjedisin strategjik të Kosovës duke përdorur ndikimin e saj. Pas tensionit të vitit 2023 në veri, BE-ja vendosi masa të përkohshme dhe të kthyeshme ndaj Kosovës në qershor 2023. Në maj 2025 Komisioni filloi lehtësimin e këtyre masave, të cilat u hoqën plotësisht në mars 2026. Megjithatë, masat kufizuese shkaktuan humbje të rëndësishme financiare. Deri në mesin e vitit 2025, disa vlerësime sugjerojnë se rreth 613.4 milionë euro në projekte ishin pezulluar ose vonuar dhe mbi 7 milionë euro ishin humbur përgjithmonë.³⁷ Përtej ndikimit material, masat dëmtuan reputacionin dhe imazhin e Kosovës, pasi që ajo u përjashtua nga shumë takime dhe procese të lidhura me BE-në. Gjatë kësaj kohe, angazhimi dypalësh i kryeministrit me vendet anëtare të BE-së ishte shumë i limituar dhe kryesisht i kufizuar në mjedise shumëpalëshe, kryesisht brenda Procesit të Berlinit dhe Komunitetit Politik Evropian. Në praktikë, presidentja Vjosa Osmani-Sadriu mori një rol diplomatik kompensues, duke ndjekur një politikë të jashtme aktive dhe duke vepruar si anashkalim de facto

në marrëdhëniet e jashtme. Ajo shihej gjerësisht nga partnerët ndërkombëtarë si më konstruktive dhe bashkëpunuese, ndryshe nga kryeministri, angazhimi i të cilit me kryeqytetet e BE-së mbeti i kufizuar.

NATO është partneri themelor i sigurisë së Kosovës. Bazuar në raportin vjetor të Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, “në tetor 2025, 33 aleatë dhe partnerë kanë siguruar rreth 5,200 trupa për KFOR-in, përfshirë forcat rezervë të dislokuara”³⁸ dhe NATO e ka bërë të qartë se KFOR-i është reaguesi i tretë ndaj incidenteve të sigurisë, pas Policisë së Kosovës dhe EULEX-it. Pas sulmit terrorist në Banjskë në vitin 2023, NATO dërgoi deri në 1,000 trupa shtesë, duke shënuar rritjen më të madhe në dhjetë vjet, dhe e përforcoi praninë e KFOR-it në veri. Kjo i siguron Kosovës një frenues të qëndrueshëm, por gjithashtu tregon se forcat e sigurisë së Kosovës ende veprojnë brenda një sistemi ku ka fjalën e fundit për çështjet e vështira të sigurisë e ka NATO. Për liderët e Kosovës kjo do të thotë se modernizimi i mbrojtjes është i rëndësishëm për gatishmërinë dhe profesionalizmin, por fuqia frenuese e vërtetë ende varet nga prania dhe mbështetja politike e NATO-s. Kjo ka rëndësi për politikën e jashtme dhe të sigurisë së Kosovës, sepse marrëdhëniet e saj me NATO-n aktualisht janë funksionale dhe jo formale. Pengesa politike është e njohur, pasi që katër anëtarë të NATO-s ende nuk e njohin Kosovën.

Shtetet e Bashkuara janë partneri më i rëndësishëm strategjik i Kosovës, por periudha 2021-2025 tregoi se Kosova nuk mund të varet gjithmonë nga mbështetja automatike prej Uashingtonit. Zotimet e Uashingtonit të ndërmjetësuara nga SHBA-ja në vitin 2020 aktivizuan bisedimet për normalizimin ekonomik me Serbinë. Nga fundi i vitit 2022, Uashingtoni dhe Brukseli u përqendruan në uljen e tensioneve dhe menaxhimin e krizave politike në veri. Në shtator 2025, Shtetet e Bashkuara e pezulluan dialogun strategjik me Kosovën. Ambasada e SHBA-së përmendi veprimet e qeverisë

37 Lexoni më shumë në: <https://newunionpost.eu/2025/12/22/eu-measures-kosovo-lifted-commission/#:~:text=The%20financial%20impact%20of%20the,under%20the%20IPA%202020%20agreement.>

38 Lexoni më shumë në: <https://www.nato.int/content/dam/nato/webready/documents/publications-and-reports/annual-reports/sgar25-en.pdf>, p. 40

në detyrë që rritën tensionet dhe mungesën e stabilitetit, së bashku me vonesat e vazhdueshme në formimin e institucioneve pas zgjedhjeve të shkurtit të vitit 2025.³⁹ Kjo ishte një lëvizje e rëndësishme politike sepse marrëdhënia me SHBA-në ka qenë prej kohësh themelore për sigurinë e Kosovës. Mësimi është i qartë: lidhjet e ngushta të Kosovës me Shtetet e Bashkuara varen nga disiplina strategjike, koordinimi me partnerët dhe institucionet efektive, jo vetëm nga vullneti i mirë në të kaluarën.

Serbia mbetet sfida kryesore e jashtme në fushën e sigurisë së Kosovës. Kjo ishte e dukshme në ngjarje si kriza e targave, barrikatat e vitit 2022, kërkesa e Serbisë për të dërguar deri në 1,000 trupa ushtarake dhe policore në Kosovë⁴⁰, kriza me komunitatet e vitit 2023 dhe sulmi terrorist në Banjskë. Raporti i Komisionit për Serbinë për vitin 2025 sugjeron se për BE-në progresi në dialogun e normalizimit është ende esencial për përparimin e të dy vendeve drejt procesit të anëtarësimit në Union. Ai gjithashtu vëren veprimet e përsëritura serbe që shkelin Marrëveshjen për Rrugën drejt Normalizimit, të tilla si lobimi kundër anëtarësimit të Kosovës në organizata ndërkombëtare dhe dështimi për të siguruar llogaridhënie për sulmin në Banjskë. Kjo ka rëndësi sepse Kosova përballet me një fqinj që e sfidon shtetësinë e saj, mbështet veprimet destabilizuese në veri dhe përpiqet të ruajë ndikimin mbi qasjen që jepet Kosovës në nivel ndërkombëtar.⁴¹

Ndikimi i Ruisë është më pak i drejtpërdrejtë, por gjithsesi i rëndësishëm pasi që kufizon integrimin dhe njohjen ndërkombëtare të Kosovës.⁴² Konfrontimi më i gjerë i Ruisë me Perëndimin pas nisjes së luftës për pushtimin e Ukrainës e ka formësuar më tej këtë dinamikë. Ndryshe nga qasja balancuese e Serbisë, përafrimi i plotë i Kosovës me sanksionet e BE-së kundër Ruisë dhe mbështetja e vazhdueshme për Ukrainën e kanë rritur vlerën e saj për BE-në, por gjithashtu janë kthyer në cak për ndikimin keqdashës rus. Brukseli vazhdimisht e ka mirëpritur përafrimin e fortë të Kosovës me

Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë së BE-së, duke e parë Kosovën si akter politikisht të besueshëm në një mjedis gjeopolitik të polarizuar.

Konfrontimi më i gjerë i Ruisë me Perëndimin pas nisjes së luftës për pushtimin e Ukrainës e ka formësuar më tej këtë dinamikë. Leva kryesore e Ruisë në lidhje me Kosovën është ndërkombëtare, jo vendore. Moska e mbështet vazhdimisht qëndrimin e Serbisë kundër njohjes së Kosovës. Ajo përdor fuqinë e saj të përhershme të vetos në Këshillin e Sigurimit të OKB-së për ta bllokuar anëtarësimin e Kosovës në OKB dhe organizata të tjera ndërkombëtare aty ku mundet. Për shkak të këtyre kufizimeve strukturore, politika e jashtme e Kosovës ka evoluar rreth tre prioriteteve të ndërlidhura: (1) zgjerimi i njohjes ndërkombëtare aty ku është e mundur, (2) thellimi i integritimit në strukturat evropiane dhe transatlantike dhe (3) puna për integrim funksional me organizatat ndërkombëtare dhe mekanizmat e BE-së aty ku është i bllokuar anëtarësimi formal. Ndryshe nga qasja balancuese e Serbisë, përafrimi i plotë i Kosovës me sanksionet e BE-së kundër Ruisë dhe mbështetja e vazhdueshme për Ukrainën e kanë rritur vlerën e saj për BE-në. Brukseli vazhdimisht e ka mirëpritur përafrimin e fortë të Kosovës me Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë së BE-së, duke e parë Kosovën si akter politikisht të besueshëm në një mjedis gjeopolitik të polarizuar.

Në frontin e brendshëm, hulumtimet ekzistuese sugjerojnë se Kisha Ortodokse Serbe (KOS) është një nga kanalet më të rëndësishme për ndikimin rus në Kosovë. Ish-zyrtarë të Kosovës dhe zyrtarë të sigurisë ndërkombëtare me bazë në Kosovë, të cituar në hulumtimet aktuale, argumentojnë se asnjë institucion tjetër serb nuk ka kapacitet më të madh për të projektuar narrativa në përputhje me interesat strategjike ruse.⁴³ Siç vërehet nga hulumtimi i Vllasit, kritikët argumentojnë se portretizimi i KOS-it si vegël e Ruisë e thjeshton së tepërmi rolin dhe motivet e saj.⁴⁴ Ata vërejnë se nëse Kisha do të udhëhiqej kryesisht nga preferencat politike ruse ose serbe, ajo ka të ngjarë

39 Lexoni më shumë në: <https://www.atlanticcouncil.org/blogs/new-atlanticist/why-did-the-us-suspend-its-strategic-dialogue-with-kosovo-and-whats-next/>

40 Lexoni më shumë në: <https://www.reuters.com/world/europe/serbia-ask-nato-deploy-serb-military-police-kosovo-vucic-2022-12-10/>

41 Shihni për shembull: Reuters, "Ministri i Kosovës thotë se Serbia synon ta destabilizojë vendin", <https://www.reuters.com/world/europe/tensions-rise-northern-kosovo-local-serbs-block-roads-serbia-puts-army-alert-2022-12-27/> dhe Koha.net <https://www.koha.net/en/veshtrime/perpjekjet-e-serbise-per-te-destabilizuar-kosoven-taktikat-e-luftes-hibride-dhe-rol-i-sherbimeve-te-inteligjences-dhe-sigurise-serbe>

42 Elis Vllasi, 2020, "Ndikimi rus në Kosovë: nën hijen e mitit dhe realitetit" https://qkss.org/images/uploads/files/Report_-_Russian_Influence_in_Kosovo_-_English_Version.pdf

43 Vllasi, 2020, fq. 20

44 Po aty.,

të kishte miratuar ndarjen e Kosovës përgjatë vijave etnike, një rezultat që thuhet se është favorizuar nga Presidenti i Serbisë. Në vend të kësaj, Asambleja e Shenjtë e Peshkopëve të KOS-it e hodhi poshtë unanimisht ndarjen etnike në nëntor 2018.⁴⁵

Kina luan një rol tjetër në mjedisin strategjik të Kosovës. Angazhimi kinez në Ballkanin Perëndimor, përfshirë Kosovën, nuk kufizohet vetëm në tregti, investime ose infrastrukturë. Mjetet ekonomike janë pjesë e një strategjie më të gjerë për të formësuar mjediset politike. Angazhimi i Kinës me Kosovën është i tërthortë dhe asimetrik.⁴⁶ Ajo e trajton Ballkanin Perëndimor si një sistem rajonal dhe jo si shtete të izoluar. Ndikimi i fituar në Serbi dhe gjetkë përhapet në Kosovë me mjete ekonomike, teknologjike dhe përmes narrativave. Ashtu si Rusia, Pekini është pjesë e bllokut shumëpalësh që e mban Kosovën jashtë OKB-së dhe organizatave të tjera ndërkombëtare. Megjithatë, ndikimi i Kinës në sigurinë ekonomike të Kosovës është më shqetësues. Në vitin 2025, importet nga Kina kapën 920 milionë euro, duke e bërë atë një nga furnizuesit më të mëdhenj të vendit dhe duke sjellë riskun e varësisë së mundshme nga furnizimet e Kinës, edhe pse Kina nuk e njeh Kosovën.⁴⁷

Tajvani mund të bëhet një partner më i rëndësishëm për Kosovën, megjithëse ende nuk është përdorur sa duhet. Ai nuk do t'i zëvendësonte boshtet kryesore euroatlantike të Kosovës, por do të shërbente si një zgjatim praktik i tyre. Vitet e fundit, marrëdhënia ndërmjet Kosovës dhe Tajvanit ka kaluar nga vullneti i mirë simbolik në bashkëpunim të strukturuar parlamentar dhe komunal. Grupi Parlamentar i Miqësisë Kosovë-Tajvan u krijua në vitin 2021 së bashku me një asociacion parlamentar Tajvan-Kosovë. Delegacioni i parë parlamentar ndërpartiak i nivelit të lartë nga Kosova e vizitoi Tajvanin në mars 2023. Ish-kryeministri Avdullah Hoti udhëhoqi një delegacion tjetër në prill 2024 me Artan Abrashin, bashkëkryetar i Grupit Parlamentar të Miqësisë Kosovë-Tajvan. Në mars 2024, Prishtina

dhe Kaohsiung nënshkruan një marrëveshje binjakëzimi të fokusuar në trafikun inteligjent, kujdesin shëndetësor inteligjent, transformimin digjital, kulturën, arsimin dhe bashkëpunimin për startup-et. Tajvani i sheh si fusha premtuese për bashkëpunim fushat e luftës kundër dezinformimit, parandalimit të fatkeqësive dhe ndihmës në raste të fatkeqësive, si dhe zinxhirët rezilientë të furnizimit.

Bartësit e pasaportave të Kosovës kanë të drejtë për viza elektronike të Tajvanit sipas kritereve përkatëse dhe shkëmbimet zyrtare kanë vënë re praninë e studentëve kosovarë në Tajvan. Për Kosovën, thellimi i këtyre lidhjeve sjell tri përfitime: do të përforconte përafrimin me Shtetet e Bashkuara dhe kampin më të gjerë demokratik; do të hapte kanale konkrete në lidhje me qeverisjen digjitale, inovacionin, arsimin dhe reziliencën; dhe të krijojë një mjet modest, por të dobishëm ndaj Kinës duke treguar se Kosova është e gatshme t'i zgjerojë lidhjet përmbajtësore me Tajvanin kur i shërben interesave të saj strategjike. Kosova duhet ta trajtojë këtë partneritet jo si simbolikë, por si një instrument të kalibruar të politikës së jashtme dhe të sigurisë.

Siç tregon Kapitulli 4, Kosova vepron brenda një konteksti të ngushtë, por deri diku të qartë, me përafrim të fortë politik me BE-në dhe Shtetet e Bashkuara, varësi nga NATO për siguri të fortë dhe presion të vazhdueshëm të jashtëm nga Serbia, e mbështetur nga Rusia dhe Kina në arenat ndërkombëtare. Në të njëjtën kohë, faktorët e brendshëm si paqëndrueshmëria institucionale, si dhe krizat e përsëritura në veri, e kanë zvogëluar besueshmërinë dhe hapësirën për manovrim të Kosovës me aleatët kyç. Kjo krijon një paradoks ku Kosova është strategjikisht e përafruar fort me Perëndimin, por operacionalisht e kufizuar në avancimin e objektivave të saj. Sfidat kryesore të politikës së jashtme dhe të sigurisë së Kosovës shfaqen në këtë kontekst si presione të ndërlidhura që e formësojnë aftësinë e saj për të vepruar.

45 Po aty.,

46 Lexoni më shumë në: <https://qkss.org/en/publikimet/beyond-economic-considerations-new-frontiers-of-chinese-influence-in-the-western-balkans>

47 Lexoni më shumë në: https://qkss.org/images/uploads/files/Fin_With_imports_of_around_€900_million_in_2025%2C_is_Kosovo_moving_toward_.....pdf

5. SFIDAT KRYESORE TË POLITIKËS SË SIGURISË DHE TË JASHTME TË KOSOVËS

Politika e jashtme dhe e sigurisë së Kosovës është ambicioze. Programi i Qeverisë 2021-2025⁴⁸ shprehet se politika e jashtme e Kosovës duhet të jetë e pavarur, serioze, e parashikueshme dhe e guximshme, duke punuar ngushtë me Shtetet e Bashkuara dhe BE-në. Ai përdor standardet e NATO-s si udhëzuesin kryesor për zhvillimin e sigurisë dhe mbrojtjes. Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2030⁴⁹ rendit gatishmërinë e lartë për paqe dhe siguri dhe forcimin e subjektivitetit ndërkombëtar si objektivat madhore të Republikës së Kosovës. Këto janë caqe të mira. Megjithatë, viteve të fundit, përparimi real shpesh nuk i ka përmbushur këto plane. Siç theksoi Kosovo 2.0 në analizën e vet për qeverinë Kurti në mars 2024, reformat e brendshme u lanë kryesisht në hije nga çështjet që lidhen me Serbinë dhe dialogun e vazhdueshëm, dhe marrëdhëniet me SHBA-në dhe BE-në u bënë më të vështira.⁵⁰

Sipas raportit të Lëvizjes FOL për Programin e Qeverisë 2021-2025, problemi kryesor ishte pamundësia për të arritur objektivat që ishin vendosur.⁵¹ Raporti thekson se përparimi në sektorë të ndryshëm u ngadalësua nga vonesat procedurale, planifikimi i dobët teknik dhe koordinimi i dobët midis institucioneve. Në politikën e jashtme, hendeku midis synimeve dhe rezultateve ishte shumë i qartë. Raporti i Lëvizjes FOL shprehet se “Në raport me NATO-n, Kosova ka pësuar kthim prapa të konsiderueshëm. Përjashtimi i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) nga pjesëmarrja në

stërvitjen ushtarake “Defender Europe ‘23” ka qenë një goditje e madhe për përpjekjet e Kosovës për t’u integruar më tej në strukturat euroatlantike”.⁵² Raporti thekson se megjithëse Kosova e bëri prioritet integrimin në BE dhe NATO në fillim të vitit 2021, viti 2025 përfundoi me Kosovën nën masat kufizuese të BE-së, anulimin e lansimit të dialogut strategjik, dështimin në përpjekjen për t’u anëtarësuar në Këshillin e Evropës si dhe për të siguruar statusin e kandidatit në BE.

“Sipas mendimit tim, sfidat mbizotëruese të politikës së jashtme dhe të sigurisë së Kosovës rrjedhin nga ndryshimet rrënjësore të koncepteve mbi bazën e të cilave u krijua shteti i Kosovës. Rendi liberal dhe rendi ndërkombëtar i bazuar në rregulla kanë siguruar mbrojtje nominale dhe në një farë mase edhe përmbajtësore që Kosova të avancojë në trajektoren e saj të shtetndërtimit. Nga ana tjetër, këto norma siguruan edhe kufizime për avancimin e mëtejshëm të kësaj trajektoreje, sepse disa vende po e përdornin pikërisht rendin ndërkombëtar të bazuar në rregulla që pengonte rrugën e Kosovës drejt organizatave ndërkombëtare. Përderisa trazirat ekzistuese janë sfida e jashtëzakonshme për vendet e vogla, përfshirë Kosovën, ato mund të shërbejnë edhe si një mundësi nëse Kosova e gjen rrugën siç duhet dhe në kohë”. (Intervistë me zyrtar të lartë qeveritar, mars 2026)

48 Lexoni më shumë në: <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/04/Programi-i-Qeverise-se-Kosoves-2021-2025.pdf>

49 Lexoni më shumë në: <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/11/NDSP-2030-dokumenti-i-dizajnuar.pdf>

50 Lexoni më shumë në: <https://archive.kosovotwopointzero.com/tri-vjet-te-qeverise-kurti-qysh-po-shkon/>

51 Lexoni më shumë në: <https://levizjafol.org/wp-content/uploads/2025/02/86-Programi-i-Qeversie-ALB04.pdf>

52 Shihni raportin e Lëvizjes FOL, fq. 26, <https://levizjafol.org/wp-content/uploads/2025/02/86-Programi-i-Qeversie-ALB04.pdf>

5.1 SFIDAT E SIGURISË

Sfida më e madhe dhe më e ngutshme e sigurisë për Kosovën është potenciali për paqëndrueshmëri në veri të vendit. Kjo është më shumë se thjesht një çështje lokale, sepse veriu i Kosovës është një përzjerje komplekse e çështjeve të ndërlydhura të sigurisë. Veriu është një zonë ku ndeshen tensionet ndëretnike, ndikimi i Serbisë, grupet e krimit të organizuar dhe strategjia më e gjerë e Kosovës. Siç vuri në dukje një zyrtar publik i lartë i intervistuar për këtë raport: “arritja e njohjes reciproke dhe vendosja e marrëdhënieve të plota fqinjësore e të mira me Serbinë do të mbetet sfida më e rëndësishme”. Me këtë u pajtua edhe një ish-zyrtar i lartë i sigurisë i intervistuar për raportin, duke thënë se normalizimi është crucial sepse do të ulte risqet e sigurisë dhe do të përmirësonte reputacionin ndërkombëtar të Kosovës. Kjo pikëpamje ndahet gjerësisht. Për sa kohë që veriu mbetet një burim i krizës së mundshme me efekt përhapës në marrëdhëniet e Kosovës me aleatët jetikë, si BE-ja dhe SHBA-ja, Kosova ka të ngjarë të vazhdojë të përqendrohet në menaxhimin e krizave, në vend që të ndërtojë procese afatgjata për integrimin e zonës. Çelësi për ta arritur këtë të fundit është themelimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, të cilin qeveria Kurti ka treguar se nuk ka shumë gjasa ta ndër marrë.

Për serbët e Kosovës, siguria në veri ishte/është e tensionuar dhe shihet si aspekt kyç i situatës së të drejtave të njeriut.⁵³ Raporti i Shoqërisë Civile për të Drejtat e Njeriut në Kosovë për vitin 2024 vëren se veprimet e qeverisë së Kosovës, si mbyllja e pesë institucioneve ilegale të financuara nga Serbia në veri, i rritën tensionet, kurse sipas OJQ-së AKTIV nga Kosova, këto sollën kthime mbrapa për sa i përket të drejtave themelore civile, duke përfshirë sigurinë, lirinë e lëvizjes, protestat paqësore dhe liritë e tjera sociale.⁵⁴ Raporti tregon gjithashtu se për serbët e Kosovës siguria në veri është e lidhur drejtpërdrejt me përfaqësimin, besimin dhe qasjen në shërbime. Pas dorëheqjes masive të zyrtarëve serbë të Kosovës dhe bojkotit të institucioneve lokale, veriu u la me një hendek legjitimiteti.

Përkundër sfidave të rënda në veri dhe nevojës që qeveria të ketë një strategji racionale dhe kuptimplote të integritit të zonës, ka disa lajme të mira për veriun. Operacionet policore në veri të Kosovës i kanë dhënë goditjen më të rëndë strukturave të krimit të organizuar në zonë. Qeveria e Kosovës bëri përparim në forcimin e pranisë së policisë, nxitjen e kapaciteteve të zbatimit të ligjit dhe luftimin e fortë të aktivitetit kriminal të organizuar në veri. Raporti i Komisionit Evropian për vitin 2024 vuri në dukje shprehimisht profesionalizmin e Policisë së Kosovës pas Banjaskës, progresin në riorganizimin e policisë, rekrutimin e zyrtarëve policorë serbë të Kosovës dhe intensifikimin e përpjekjeve kundër kontrabandës dhe krimit të organizuar në komunat në veri. Aktakuza kundër 45 të dyshuarve për sulmin në Banjaskë, përfshirë Milan Radoičiqin, nënvizoi më tej se institucionet e Kosovës ishin të gatshme të punojnë për t'i sjellë para drejtësisë rrjetet e lidhura me dhunën dhe shtrëngimin në veri.⁵⁵

Sfidë tjetër është militarizimi në rritje në rajon dhe lëvizjet më të gjera strategjike të Serbisë. Një zyrtar i lartë publik i intervistuar për këtë raport paralajmëroi për një “trend të frikshëm të armatimit në Kosovë dhe më gjerë”. Një ish-zyrtar i lartë i sigurisë gjithashtu vuri në dukje militarizimin e vazhdueshëm të Serbisë dhe lidhjet e saj më të ngushta me Rusinë dhe Kinën si shqetësime të vazhdueshme. Raporti i QKSS-së ka ngritur vëmendjen ndaj “Projektit 5000” të Serbisë⁵⁶ Raporti i QKSS-së për doktrinën e sigurisë së Serbisë thekson se Serbia nuk e sheh Kosovën thjesht si një kontest politik, por si një shqetësim kryesor të sigurisë kombëtare.⁵⁷ Strategjia e Sigurisë Kombëtare e Serbisë për vitin 2021 e përshkruan pavarësinë e Kosovës si një kërcënim të drejtpërdrejtë për integritetin e saj territorial dhe e bën këtë pikëpamje qendrore në politikën e saj të sigurisë. Për shkak të kësaj, veprimet e Serbisë shkojnë përtej diplomacisë dhe përfshijnë punën e inteligjencës, forcimin ushtarak dhe taktika hibride si përhapja e dezinformave dhe lobimi pranë vendeve të tjera për ta sfiduar shtetësinë e Kosovës

53 Lexoni më shumë në: <https://newsocialinitiative.org/wp-content/uploads/2025/05/04-Report-Civil-Society-Report-on-Human-Rights-2024-ENG-04.pdf>

54 Shihni Raportin e Shoqërisë Civile për të Drejtat e Njeriut në Kosovë për vitin 2024, <https://newsocialinitiative.org/wp-content/uploads/2025/05/04-Report-Civil-Society-Report-on-Human-Rights-2024-ENG-04.pdf>

55 Lexoni më shumë në: <https://balkaninsight.com/2024/09/11/kosovo-indicts-45-for-deadly-attack-by-armed-serb-group-in-banjska/bi/>

56 Lexoni më shumë në: https://qkss.org/images/uploads/files/What_is_Serbia's_'Project_5000'_and_why_should_we_be_concerned.pdf

57 Lexoni më shumë në: https://qkss.org/images/uploads/files/How_Serbian_security_doctrine_views_Kosovo%2C_the_West%2C_Russia_and_China.pdf

dhe për ta bllokuar njohjen e saj ndërkombëtare. Në të njëjtën kohë, strategjia e Serbisë ka dy anë: ajo punon me BE-në dhe NATO-n, por gjithashtu forcon lidhjet e saj me Rusinë dhe Kinën, të cilat e mbështesin Serbinë politikisht dhe inkurajojnë një qëndrim më konfrontues ndaj Kosovës. Për Kosovën, kjo do të thotë se nuk ka të bëjë vetëm me një fqinj që e kundërshton pavarësinë e saj, por me një fqinj politikat e sigurisë të të cilit mbështesin në mënyrë aktive përpjekjet për ta sfiduar Kosovën në fushat diplomatike, informative dhe të sigurisë. Cenueshmëria e Kosovës qëndron në ndërveprimin midis manipulimit të jashtëm të informacionit (FIMI) dhe dobësive të brendshme strukturore, të tilla si edukimi i kufizuar medial, koordinimi i pamjaftueshëm institucional dhe mekanizmat e dobët të zbatimit. Këto kushte e bëjnë Kosovën një terren pjellor për dezinformim. Analiza e bërë nga Hibrid.info për rrjetin rus "Pravda" tregon se kjo sfidë është kthyer në kërcënim hibrid më të organizuar dhe sistemik.⁵⁸ Raporti e bën të qartë se vendet e Ballkanit, përfshirë Kosovën, nuk janë thjesht caqe anësore, por janë pjesë e një mjedisi të planifikuar informativ ku rrjetet e lidhura me Rusinë punojnë në shkallë të gjerë, duke krijuar shumë përmbajtje që synojnë audiencën lokale. Për përmbajtjen në gjuhën shqipe, mesazhet shpesh e përshkruajnë NATO-n si agresor, BE-në si joefektive dhe Shtetet e Bashkuara si manipuluese. Në të njëjtën kohë, ata mohojnë shtetësinë e Kosovës dhe pretendojnë se institucionet e saj janë ose të paligjshme ose represive ndaj komunitetit serb të Kosovës.

Kjo është e rëndësishme për sigurinë e Kosovës sepse, siç theksojnë të dy raportet, dezinformimi tani ka të bëjë më pak me bindjen e njerëzve dhe më shumë me mbingarkimin e tyre dhe formësimin e mjedisit të informacionit. Rrjeti "Pravda" është një sistem i madh ueb faqesh të automatizuara ose gjysmë të automatizuara që vazhdojnë të përsërisin dhe riciklojnë storje të caktuara, shpesh të marra nga mediat shtetërore ruse dhe burime të ngjashme.⁵⁹ Synimi është që pikëpamje të caktuara të duken normale. Edhe nëse jo shumë njerëz e shohin çdo artikull, vëllimi i madh ndihmon që këto mesazhe armiqësore të mbeten. Strategjia e tyre

është gjithashtu të ndikojnë në motorët e kërkimit, platformat digjitale dhe madje edhe sistemet e IA-së duke i përmbytur ato me këtë përmbajtje, një taktikë që analistët e quajnë përmbajtje të përmbajtjes ose "LLM grooming".⁶⁰

Në një tryezë rajonale për Manipulimin dhe Ndërhyrjen e Huaj në Informacion (FIMI) të organizuar nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) në mars të vitit 2026, pjesëmarrësit u pajtuan se Kosova duhet ta shohë FIMI-n si një kërcënim hibrid, jo thjesht si sfidë komunikimi. Ata theksuan se manipulimi nuk mbështetet në gënjeshtër të izoluar, por përfiton nga dobësitë ekzistuese në shoqëri, të tilla si koordinimi i dobët midis institucioneve, besimi i ulët i publikut, marrëdhëniet e brishta ndëretnike, komunikimi i kufizuar strategjik dhe natyra e shpejtë dhe e errët e platformave digjitale. Rreziku i vërtetë nuk është vetëm përhapja e storjeve mashtruese, por përpjekja për të ndikuar në mënyrën si e kuptojnë njerëzit legjitimitetin, sovranitetin dhe sigurinë, veçanërisht gjatë zgjedhjeve, incidenteve të sigurisë, pasigurisë politike ose bisedimeve të ndjeshme me Serbinë. Tryeza theksoi se narrativat manipuluese janë veçanërisht të rrezikshme në Kosovë sepse ato mund t'i kthejnë ngjarjet e izoluar në kërcënime të perceptuara kolektive, të rrisin frikën dhe ndarjen midis komuniteteve dhe të gërryjnë besimin në institucione përpara çdo përgjigjeje zyrtare. Ata gjithashtu vunë në dukje se këto narrativa shpesh shkojnë përtej dezinformative të thjeshta. Ato sfidojnë shtetësinë, forcën institucionale dhe partneritetet ndërkombëtare të Kosovës dhe përhapen nga zërat lokalë, mediat rajonale dhe burimet e huaja të lidhura me shtetet.

Kjo është arsyeja pse FIMI u diskutua si pjesë e një mjedisi më të gjerë të kërcënimit hibrid. Ai lidhet me çështje si dinamika e platformave, shpëlarja e narrativave ndërkufitare, dobësitë kibernetike dhe të zbatimit të ligjit, dhe teknologjitë e reja si IA, të cilat mund të përhapin shpejt pikëpamje të njëanshme ose jo të plota për Kosovën. Tryeza e rrumbullakët arriti në përfundimin se Kosova nuk mund të mbështetet në demantime që bëhen nga një herë. Në vend të kësaj, vendi ka nevojë për një sistem të përhershëm ndërinstitutional,

58 Shihni "Rrjeti propagandistik rus Pravda dhe Ballkani", nga Festim Rizanaj, <https://hibrid.info/the-russian-propaganda-network-pravda-and-the-balkans/>

59 Lexoni më shumë në <https://hibrid.info/wp-content/uploads/2025/06/Rrjeti-Pravda-5-1.pdf>

60 I referohet manipulimit të qëllimshëm dhe sistematik të modeleve të mëdha gjuhësore (LLM) duke e tejgopur internetin me dezinformim, propagandë ose përmbajtje të njëanshme qëllimisht të dizajnuara për t'u absorbuar në grupet e të dhënave të ardhshme të trajnimit. Kjo praktikë përbën një formë helmimi të të dhënave dhe përfaqëson një kategori të re kërcënimi kognitiv, përmes të cilit akterët keqdashës përpiqen të "trajnojnë" sistemet e IA-së për të përvetësuar narrativat e shtrëmbëruara dhe për të riprodhuar informacione të fabrikuara.

mjete më të mira të paralajmërimit të hershëm, monitorim dhe komunikim dygjuhësh, lidhje më të forta me shoqërinë civile dhe mediat investigative dhe bashkëpunim më të ngushtë me BE-në dhe NATO-n në fusha si siguria kibernetike, komunikimi strategjik, zbatimi i ligjit dhe rezilienca të bazuar në të drejta. Në përmbledhje, tryeza argumentoi se FIMI është një sfidë serioze për Kosovën sepse ka si cak fushat ku ndeshen kontestet politike, dobësia sociale dhe hendekët institucionalë. Për këtë arsye, duhet të trajtohet si çështje themelore e politikës së jashtme dhe të sigurisë, jo thjesht një shqetësim medial.

Një zyrtar i lartë qeveritar i intervistuar për këtë raport paralajmëroi se “pasiguritë e përgjithshme në zhvillim që rrjedhin nga fusha kibernetike (IA) dhe, veçanërisht, siguria energjetike, përfaqësojnë një shqetësim të madh” dhe shtoi se këtyre fushave “duhet t’u jepet përparësi absolute”. Sfida e sigurisë kibernetike në Kosovë nuk është mungesa e ligjeve apo institucioneve, por dobësitë në kapacitete dhe reziliencë. Siç tregon dokumenti i Grupit për Ballkanin përmes sulmeve të vitit 2022 ndaj shërbimeve publike si eKosova, incidentet kibernetike në Kosovë nuk janë ngjarje teknike të izoluar.⁶¹ Ato ndikojnë drejtpërdrejt në vazhdimësinë e shërbimeve shtetërore, besimin e publikut dhe besueshmërinë institucionale. Dokumenti argumenton se Kosovës i mungon trekëndëshi i plotë operacional i njerëzve, proceseve dhe mjeteve, duke pasur pak profesionistë të trajnuar, investime të pamjaftueshme në mbrojtjen kibernetike, thellësi të limituar të reagimit ndaj incidenteve dhe një kornizë rregullatore jo të plotë për zbulimin e cënueshmërive, raportimin dhe zbatimin. Dokumenti i QKSS-së e përforcon këtë diagnozë nga perspektiva rajonale dhe e BE-së.⁶² Ai vëren se Kosova ka miratuar një ligj për sigurinë kibernetike, një strategji 2023-2027, dhe ka krijuar një agjenci të dedikuar dhe struktura policore për krimin kibernetik, duke e vendosur atë përpara disa shteteve të Ballkanit Perëndimor sa i përket strukturës formale. Megjithatë, ai gjithashtu nënvizon se Kosova mbetet vetëm pjesërisht e përafuar me standardet e BE-së, ende duhet të përafrohet me NIS II dhe Kutinë

e Mjeteve të Sigurisë Kibernetike 5G, nuk është ende palë në Konventën e Budapestit dhe duhet të investojë më shumë në kapacitete teknike, mekanizma operacionalë dhe ekspertizë gjyqësore dhe prokuroriale. Implikimi është se problemi kibernetik i Kosovës ka të bëjë me mënyrën si të sigurohen kapacitetet dhe resurset e nevojshme për t’i bërë ligjet, politikat dhe institucionet ekzistuese të funksionojnë në mënyrë efektive. Nëse nuk forcohen paralajmërimi i hershëm, mbrojtja e infrastrukturës kritike, koordinimi ndërinstitutional dhe lidhjet me arkitekturën e sigurisë kibernetike të BE-së, modernizimi digjital i Kosovës do të vazhdojë ta tejkalojë reziliencën e saj digjitale.

Koordinimi i dobët ndërmjet institucioneve dhe përcjellja jokonsistente janë ende probleme të mëdha të sigurisë brenda Kosovës. Ka shumë dokumente, plane dhe deklarata, por jo veprime të mjaftueshme. Një ish-zyrtar i lartë i sigurisë paralajmëroi se koordinimi i dobët midis Presidencës dhe Qeverisë ka çuar në “mesazhe jo konsistente ndaj partnerëve ndërkombëtarë”, çka e dëmton “koherencën dhe besueshmërinë” e diplomacisë së Kosovës. Kjo është çështje serioze. Për Kosovën, koordinimi i dobët i brendshëm ndikon në siguri sepse aleatët dhe partnerët e jashtëm shikojnë se çfarë bën Prishtina dhe sa konsistente janë veprimet e saj. Një tjetër sfidë në rritje e sigurisë për Kosovën është menaxhimi i marrëdhënieve të saj me SHBA-në, NATO-n dhe BE-në. Kjo pikë duhet të bëhet më e qartë. Kosova ende mbështetet në KFOR-in dhe NATO-n si garancinë kryesore të sigurisë. Përshkrimi aktual i NATO-s për KFOR-in thotë se misioni është reaguesi i tretë pas Policisë së Kosovës dhe EULEX-it. Pas sulmit terrorist në Banjskë në vitin 2023, NATO dërgoi deri në 1,000 trupa shtesë, rritja më e madhe në një dekadë. Në shkurt 2026, NATO tregoi se KFOR-i ka rreth 5,200 trupa nga 33 vende aleate dhe partnere. Në gusht 2024, KFOR-i i kërkoi publikisht qeverisë së Kosovës të mos ndërmarrë hapa të njëanshëm mbi urën e Mitrovicës, dhe NATO veç ua kishte përkujtuar të gjithëve në qershor 2023 se obligimet e tyre ndaj KFOR-it kanë për qëllim “të sigurojnë veprime të koordinuara, të shmangin përshkallëzimin dhe të ruajnë një mjedis të sigurt dhe të siguruar”.⁶³

61 Lexoni më shumë në: <https://balkansgroup.org/wp-content/uploads/2023/09/Cyber-Security.pdf>

62 Lexoni më shumë në: https://qkss.org/images/uploads/files/DESIGN_Integration_of_the_Six_Countries_of_the_Western_Balkans.pdf

63 Lexoni më shumë në: <https://balkaninsight.com/2024/08/16/eu-warns-kosovo-as-mitrovica-bridge-standoff-goes-on/bi/>

5.2 SFIDAT E POLITIKËS SË JASHTME

“Çështja më e dukshme e padiskutuar që mund të kthehet në risk, është nevoja që Kosova të konsolidojë shtetësinë e saj ndërkombëtarisht, përkatësisht njohjen nga vendet e tjera që deri më tani nuk e kanë njohur formalisht shtetësinë e saj dhe anëtarësimin në organizata ndërkombëtare. Është edhe më shqetësuese që akterët e fuqishëm si SHBA, BE-ja dhe shtetet e tjera të fuqishme dhe organizatat ndërkombëtare, madje edhe forcat politike të Kosovës, rrallë flasin për këtë nevojë ekzistenciale për Kosovën. Është e rëndë që kjo çështje që është jetike për Kosovën si shtet dhe shoqëri, është zvogëluar dhe reduktuar në mikromenaxhim konflikti të kontestit politik me Serbinë, e trajtuar përmes ‘sajesave’ transaksionale që marrin formën e ‘marrëveshjeve’ për një numër të pafund çështjesh të vogla, shpesh të parëndësishme”. (Intervistë me zyrtar të lartë publik, Qeveria e Kosovës, mars 2026)

Sfida kryesore e politikës së jashtme për Kosovën është ende normalizimi i marrëdhënieve me Serbinë. Refuzimi i vazhdueshëm i Serbisë për ta njohur të drejtën e Kosovës për të ekzistuar si shtet është sfidë strukturore e jashtme dhe e sigurisë. Ky qëndrim vazhdon pavarësisht Opinionit Këshillimor të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë të vitit 2010, i cili konfirmoi se shpallja e pavarësisë së Kosovës nuk shkel ligjin ndërkombëtar, dhe pavarësisht statusit të Kosovës që doli nga një proces politik i udhëhequr nga OKB-ja nga ish-presidenti i Finlandës Martti Ahtisaari. Në praktikë, qëndrimi i Serbisë është një strategji kontestimi, duke kombinuar pengimin diplomatik, mbështetjen për strukturat ilegale dhe paralele brenda Kosovës, dhe ndonjëherë, tolerancën ose mbështetjen e akterëve destabilizues në terren, siç është udhëheqësi i sulmit terrorist në Banjaskë Milan Radoičiqi.⁶⁴ Siç vuri në dukje një ish-zyrtar i lartë i sigurisë i qeverisë së Kosovës në një intervistë për këtë raport, mosnjohja e Serbisë nuk është vetëm simbolike, por ka implikime të drejtpërdrejta të sigurisë, pasi “kontribuon në paqëndrueshmërinë e vazhdueshme rajonale” dhe përforcohet nga mbështetja e fuqive të mëdha si Rusia dhe Kina.

Refuzimi i Serbisë për ta pranuar shtetësinë e Kosovës ka krijuar një mjedis afatgjatë ku përpjekjet

e udhëhequra nga BE-ja për normalizimin e marrëdhënieve veçse shtyhen dhe risqet e sigurisë riprodhohen në vend që të zgjidhen. Siç u tregua nga sulmi terrorist në Banjaskë dhe incidente të tjera, rrjetet e lidhura me strukturat politike dhe të sigurisë në Serbi kanë demonstruar aftësinë për të sfiduar rendin kushtetues dhe sigurinë publike të Kosovës. Në këtë kontekst, mosnjohja vepron si kornizë lejuese. Kjo i lejon Serbisë të ruajë një lloj dykuptimësie rreth përgjegjësisë të veta duke e kontestuar sovranitetin e Kosovës në fushat diplomatike, informative dhe të sigurisë. Në të njëjtën kohë, intervistat tregojnë se kjo çështje mbetet qendrore, por nuk adresohet mjaftueshëm në terma strategjike. Siç argumentoi një zyrtar i lartë publik nga qeveria e Kosovës në një intervistë për këtë raport, nevoja për ta konsoliduar shtetësinë ndërkombëtare të Kosovës dhe për të arritur njohjen reciproke shpesh “është zvogëluar dhe reduktuar në mikromenaxhim konflikti... për një numër të pafund çështjesh të vogla, shpesh të parëndësishme”, në vend që të trajtohet një prioritet ekzistencial. Kjo dinamikë ka lejuar që kontesti themelor mbi shtetësinë të vazhdojë të mbetet i pazgjidhur, ndërsa energjia politike devijohet në marrëveshje teknike që nuk e ndryshojnë rrënjësisht marrëdhënien.

Diplomacia e Kosovës ende është e prekur nga kontesti e pazgjidhur me Serbinë për statusin e vendit dhe asnjë prioritet tjetër nuk mund ta shmangë plotësisht atë. Programi i Qeverisë së Kosovës 2021-2025 ka paraparë se puna nga afër me Shtetet e Bashkuara është e rëndësishme në dialogun e normalizimit me Serbinë dhe se synimi më i madh i Kosovës është forcimi i shtetësisë së saj përmes integritit dhe njohjes. Megjithatë, në praktikë, dialogu shpesh kthehet në menaxhimin e kontesteve të vogla. Një zyrtar i lartë publik i intervistuar për këtë raport kritikoi se çështja e shtetësisë së Kosovës është reduktuar në “sajesa” transaksionale për shumë probleme të vogla. Me fjalë të tjera, shumë akterë të rëndësishëm tani përqendrohen më shumë në menaxhimin e përditshëm të krizave sesa në nevojën më të thellë të Kosovës për pranim të plotë ndërkombëtar.

⁶⁴ Lexoni më shumë në: <https://www.rferl.org/a/kosovo-indicts-banjska-attack-suspects-radoicic/33116016.html> and <https://prishtinainsight.com/who-is-milan-radoicic-the-shadow-power-of-kosovo-serbs-mag/>

Rusia dhe Kina paraqesin sfida të politikës së jashtme për Kosovën, por e bëjnë këtë në mënyra të ndryshme. Qasja e Rusisë është haptazi gjeopolitike dhe përçarëse. Sipas raportit të QKSS-së për politikën e jashtme ruse, Moska e sheh Kosovën më shumë se thjesht një kontest me Serbinë.⁶⁵ Rusia e përdor Kosovën si simbol për të vënë në dyshim intervenim perëndimor, për të sfiduar shtetësinë e Kosovës dhe për të minuar integrimin euroatlantik në Ballkanin Perëndimor. Raporti gjithashtu vë në dukje se mbështetja e Rusisë për Serbinë është pjesë e një strategjie më të gjerë për të krijuar paqëndrueshmëri, për të shfrytëzuar ndarjet etnike dhe politike dhe për të bllokuar normalizimin kurdoherë që ky do të zvogëlonte ndikimin e Moskës në rajon. Një raport tjetër i QKSS-së thekson se Rusia e përdor Kosovën si pjesë e konfrontimit të saj më të gjerë me Perëndimin, duke përhapur narrativa anti-Kosovë për të forcuar kundërshtimin e Serbisë ndaj NATO-s dhe për ta mbajtur Ballkanin politikisht të paqëndrueshëm.⁶⁶

Kina paraqet një lloj tjetër sfide të politikës së jashtme. Raporti i QKSS për "gjurmën e heshtur" të Kinës shpjegon se Pekini nuk e njeh Kosovën, por prapëseprapë angazhohet në kontakte selektive ekonomike dhe politike.⁶⁷ Këtu përfshihet puna me qeverisjet lokale dhe mbajtja e një zyre ndërlidhëse në Prishtinë që i raporton ambasadës së Kinës në Beograd. Për pasojë, Kina mund ta ngrejë praninë dhe ndikimin e saj në Kosovë, ndërsa Kosova nuk ka qasje të ngjashme në Kinë. Raporti për importet e Kosovës nga Kina gjithashtu thekson se importet pothuajse u dyfishuan nga rreth 450 milionë euro në vitin 2021 në 900 milionë euro në vitin 2025, duke e bërë Kinën një nga partnerët më të mëdhenj të importit të Kosovës, edhe pse Kosova eksporton shumë pak në Kinë.⁶⁸ Meqenëse Kina gjithashtu mbështet qëndrimin e Serbisë kundër Kosovës në forumet ndërkombëtare, kjo krijon një problem strategjik: Kosova po bëhet më e varur ekonomikisht nga një vend që nuk e njeh sovranitetin e saj.

Kosova gjithashtu e ka të vështirë ta kthejë qëndrimin e saj pro-perëndimor në qasje reale

në institucionet ndërkombëtare. Programi i Qeverisë e përshkruan Kosovën si një partner të besueshëm të SHBA-së, BE-së dhe NATO-s dhe premtion bashkëpunim më të ngushtë. Por në realitet, ky përafrim nuk ka çuar gjithmonë në rritjen e qasjes. Kosova ende nuk është në NATO, ende nuk ka njohje nga pesë vende të BE-së dhe ende përballet me pengesa politike në organizatat kryesore ndërkombëtare. Një ish-zyrtar i lartë i sigurisë i intervistuar për këtë raport tha se Kosova duhet të kishte përfituar më shumë nga situata aktuale gjeopolitike, sepse "mundësitë e humbura mund të sjellin kosto afatgjata". Me fjalë të tjera, derisa Kosova është 100% e përafruar me Perëndimin, ajo nuk e ka kthyer gjithmonë këtë në përfitime të qëndrueshme politike.

Politika e jashtme e Kosovës gjithashtu përballet me një problem besueshmërie me partnerët e saj më të ngushtë. Problemi nuk është se Kosova ka ndryshuar aleancat e saj ose ka humbur drejtimin e saj. Kjo nuk ka ndodhur. Pyetja e vërtetë është si mundet Kosova t'ua tregojë partnerëve të saj më të ngushtë se vepron në mënyrë të disiplinuar, planifikon paraprakisht dhe e kupton se vendimet janë më të forta kur përshtaten me strategjitë aleate, ose me fjalë të tjera si ta dëshmojë veten si akter racional. Programi i Qeverisë 2021-2025 ka paraparë se politika e jashtme e Kosovës duhet të jetë "e parashikueshme" dhe kjo tani është më e rëndësishme se kurrë. Nëse Kosova dëshiron lidhje më të mira me SHBA-në, lidhje më të ngushta me NATO-n dhe përparim me BE-në, ajo duhet të ketë politikën e duhura dhe gjithashtu duhet të shihet si akter i parashikueshëm dhe racional. **Një problem tjetër i madh i politikës së jashtme është se Kosova ende nuk njihet plotësisht dhe nuk mund të anëtarësohet në shumë organizata ndërkombëtare.** Kosova ka bërë disa përparime, por jo të mjaftueshme për t'i kapërcyer këto kufij bazë. Një zyrtar i lartë publik i intervistuar për këtë raport tha se nevoja për ta "konsoliduar shtetësinë e saj ndërkombëtarisht" nuk diskutohet mjaftueshëm, veçanërisht kur bëhet fjalë për njohjen nga pesë vendet e BE-së që nuk e njohin Kosovën dhe për anëtarësimin në organizatat

65 Lexoni më shumë nga raporti i KAS-it dhe QKSS-së, në dispozicion në: https://qkss.org/images/uploads/files/Publication_24-09-30_Kosovo_in_Russian_Foreign_Policy_Discourse_A4_-_2.pdf

66 Lexoni më shumë në: <https://qkss.org/en/publikimet/kercenimet-hibride-ne-nje-peizazh-gjeopolitik-ne-ndryshim-lufta-ne-ukraine-dhe-implikimet-e-saj-per-kosoven-dhe-ballkanin-perendimor>

67 Lexoni më shumë në: https://qkss.org/images/uploads/files/Gjurma_e_heshtur_e_Kines_hartezimi_i_ndikimit_kinez_ne_politiken_lokale_dhe_peizazhin_ekonomik_ne_Kosove_Eng.pdf

68 Lexoni më shumë në: <https://qkss.org/al/publikimet/with-imports-of-around-900-million-in-2025-is-kosovo-moving-toward-a-potential-dependency-on-chinas-supply-chain>

ndërkombëtare.

“Një risk kyç dhe shpesh sfidë e paadresuar në politikën e jashtme dhe të sigurisë së Kosovës qëndron në koordinimin e pamjaftueshëm ndërmjet institucioneve shtetërore, veçanërisht Presidencës dhe Qeverisë. Gjatë dy viteve të fundit, divergjencat në pozicione dhe qasje strategjike ndonjëherë kanë prodhuar mesazhe jo konsistente ndaj partnerëve ndërkombëtarë, duke minuar kështu koherencën dhe besueshmërinë e angazhimit diplomatik të Kosovës. Në disa raste, kjo mungesë përafrimi ka pasur pasoja të prekshme, duke përfshirë komunikimin e sinjaleve të përziera gjatë vendosjes së masave të Bashkimit Evropian pjesërisht të shkaktuara nga veprimet e qeverisë, si dhe pezullimin e dialogut strategjik me Shtetet e Bashkuara”. (Intervistë me ish-zyrtar të lartë të sigurisë, mars 2026)

Siç u përshkrua më lart, Kosova përballet me pak presione, të tilla si refuzimi i Serbisë për ta njohur të drejtën e Kosovës për të ekzistuar, njohja e kufizuar ndërkombëtare dhe ndikimi i jashtëm nga Rusia dhe Kina. Ajo gjithashtu ka dobësi të brendshme, duke përfshirë fragmentimin institucional dhe polarizimin e thellë politik, koordinimin e dobët dhe menaxhimin reaktiv të krizave. Këta faktorë e përforcojnë njëri-tjetrin dhe e zvogëlojnë aftësinë e Kosovës për ta kthyer përafrimin e saj të fortë euroatlantik në përfitime konkrete. Rezultati është një mjedis politik ku Kosova në praktikë është e përafruar me Perëndimin, por operacionalisht e kufizuar në avancimin e objektivave të saj themelore. Në këtë kontekst, pyetja kyçe nuk lidhet me synimet e Kosovës, por si mundet t’i prioritzojë, sekuencojë dhe zbatojë ato në mënyrë më efektive. Kapitulli 6 diskuton disa ide në këtë aspekt, duke përshkruar disa prioritetet konkrete për të cilat Kosova duhet të punojë për ta forcuar pozitën e saj.

6. ÇKA DUHET TË PRIORITIZOJË KOSOVA NË POLITIKËN E SAJ TË JASHTME DHE TË SIGURISË

Politika e ardhshme e jashtme dhe e sigurisë së Kosovës duhet të përqendrohet në një mësim kyç nga pesë vitet e fundit, që është se vendi shpesh humbet terren jo për shkak të strategjisë së dobët, por sepse lejon që krizat, sekuencimi i dobët dhe inkoherenca institucionale të konsumojnë energji politike që duhet të shpenzohet për integrim, njohje dhe konsolidim të shtetit. Nga viti 2020 deri në vitin 2025, Kosova bëri përparim në drejtimin e duhur. Ajo u përafhua plotësisht me Perëndimin për çështjet kryesore gjeopolitike, fitoi liberalizimin e vizave, aplikoi për anëtarësim në BE, punoi më nga afër me Europol-in, qëndroi e përkushtuar ndaj qëllimeve të saj euroatlantike dhe rriti shpenzimet e mbrojtjes. Megjithatë, kjo periudhë tregoi edhe kostot e tensioneve të përsëritura në veri të Kosovës, ngërçin politik në vend, reformat e papërfunduara nga procesi i anëtarësimit në BE dhe fërkimet mjaft të rregullta me Shtetet e Bashkuara, NATO-n dhe BE-në. Qeveria e ardhshme nuk ka nevojë për një strategji të re të madhe në vetvete, por duhet të vendosë prioritete më të qarta dhe të gjejë një mënyrë më të mirë për t'i arritur ato.

Intervistat e realizuara për këtë raport të shpjen në të njëjtin drejtim kur bëhet fjalë për atë që Kosova duhet të prioritzojë në politikën e saj të jashtme dhe të sigurisë, edhe nëse përdorin fjalë të ndryshme. Një zyrtar i lartë publik nga qeveria e Kosovës thotë se “arritja e njohjes reciproke dhe vendosja e marrëdhënieve të plota fqinjësore me Serbinë do të mbetet sfida më e rëndësishme”. Një zyrtar tjetër i lartë i qeverisë beson se Kosova duhet të përqendrohet në “dy shtresa paralele”, që do të thotë ndërtimi i më shumë partneriteteve dypalëshe dhe anëtarësimi në organizatat ku anëtarësimi sjell vlerë reale, si Këshilli i Evropës, BE-ja dhe INTERPOL-i. Një ish-zyrtar i lartë i sigurisë mendon se Kosova duhet të prioritzojë një “rrugë të qartë drejt anëtarësimit në NATO dhe BE” dhe paralajmëron se “mundësitë e humbura mund të sjellin kosto afatgjata”. Edhe Programi i Qeverisë

2021-2025 vendos një standard të lartë, duke thënë se politika e jashtme e Kosovës duhet të jetë “e pavarur, serioze, e parashikueshme dhe e guximshme”. Nga kjo, mesazhi është i qartë, dhe ai është se Kosova ka nevojë për drejtim. Ajo ka nevojë për më pak prioritete, por më të qarta, të ndjekura në mënyrë më konsistente, me planifikim më të mirë, koordinim më të mirë dhe më pak kriza të krijuara vetë.

SË PARI, Kosova duhet të përqendrohet në një strategji për veriun e vendit që bashkon sigurinë, shërbimet dhe përfshirjen politike, dhe jo të fokusohet kryesisht në zbatim.

Veriu është vendi ku ndeshen pothuajse të gjitha çështjet më të vështira të jashtme dhe të sigurisë së Kosovës, dhe kjo përfshin marrëdhëniet me Serbinë, pozitën e serbëve të Kosovës dhe besimin me partnerët perëndimorë (BE dhe SHBA). Qeveria e ardhshme duhet të krijojë një strategji formale për veriun dhe të marrë një qasje proaktive, në koordinim me SHBA-në dhe BE-në. Kjo strategji duhet të përfshijë një plan për të pasur shërbime publike të qasshme për qytetarët, një paketë për ngritje të besimit në sundimin e ligjit dhe policinë, hapa të qartë për të punuar me partnerët për çështje të ndjeshme dhe një dialog kombëtar që adreson shqetësimet më pragmatike të serbëve të Kosovës. Kjo ka rëndësi sepse vitet e fundit kanë treguar rezultate të përziera. Raporti i Komisionit Evropian për vitin 2025 shprehet se marrëdhëniet me komunitetin serb të Kosovës u përkeqësuan pasi që institucionet e Kosovës mbyllën shumë institucione paralele ose ilegale të mbështetura nga Serbia në mënyrë të pakoordinuar dhe pa vëmendje të mjaftueshme ndaj nevojave lokale. Në të njëjtën kohë, raporti i Komisionit për vitin 2024 vuri në dukje se policia i shtoi përpjekjet kundër kontrabandës dhe krimit të organizuar në veri dhe hetimi i sulmit terrorist në Banjskë u bë një operacion i rëndësishëm për Policinë e Kosovës. Pika kryesore është se derisa prania e shtetit në veri është rritur, legjitimiteti i tij

nuk ka ecur me të njëjtin ritëm. Ky hendek është i rrezikshëm. Një raport për të drejtat e njeriut nga grupet e shoqërisë civile thotë gjithashtu se siguria në veri mbeti e tensionuar në vitin 2024 dhe se disa serbë lokalë janë bërë më të pakënaqur me institucionet publike të Kosovës. Qeveria e ardhshme duhet të mbështetet në përparimin në zbatimin e ligjit, por duhet ta pranojë se kontrolli i vetëm nuk është strategji reale.

SË DYTI, Kosova duhet t'i shohë bisedimet e normalizimit me Serbinë si një shans për të forcuar shtetin si dhe konsolidimin rajonal, evropian dhe ndërkombëtar, jo si një barrë që duhet trajtuar me ngurrim. Ky ka të ngjarë të jetë ndryshimi më i rëndësishëm politik që duhet të bëjë qeveria e ardhshme. Kosova ka arsye për të qenë e kujdesshme në lidhje me procesin e dialogut siç ka funksionuar deri më tani. Por në vend që ta shohë atë si diçka të imponuar nga jashtë dhe jopopullore në shtëpi, Kosova duhet ta marrë kontrollin vetë. Kjo do të thotë të publikohet një plan i qartë për zbatimin e Marrëveshjes së vitit 2023 për Rrugën drejt Normalizimit dhe aneksit të saj, duke shpjeguar se çfarë do të bëjë Kosova, në çfarë rendi, me çfarë mbrojtjesh ligjore dhe çfarë pret nga BE-ja dhe Serbia, por veçanërisht nga BE-ja. Kjo do të thotë gjithashtu se procesi duhet bërë më transparent dhe të rritet mbikëqyrja parlamentare, pasi që shumëçka nga dialogu është kthyer në thashetheme dhe parulla për konsumin e brendshëm. Një zyrtar i lartë publik e tha mirë, duke thënë se çështja themelore e shtetësisë së Kosovës shumë shpesh "është zvogëluar dhe reduktuar në mikromenaxhim konflikti" dhe "sajesa" të pafundme. Kosova duhet ta shmangë këtë kurth. Një mënyrë më e mirë është t'i përmbushë detyrimet e saj në mënyrë të ndershme duke mbrojtur kufijtë e saj kushtetues. Kjo përfshin përgatitjen e një projekt-statuti për Asociacionin e Komunave me shumicë serbe për shqyrtim kushtetues, vlerësimin nëse do të riemërtohet mekanizmi dhe krijimin e një grupi ekspertësh për të shkruar një dokument koncepti përpara se të ndërmerren hapa zyrtarë. Çështja nuk është të bëjmë lëshime vetëm për hir të lëshimeve, por të kalojmë nga reagimi ndaj ngjarjeve në menaxhimin e tyre me një plan të qartë. Siç tha Gëzim Visoka në vitin 2021, Kosova duhet t'i qaset dialogut me një "plan të detajuar, të strukturuar dhe transparent".⁶⁹

Kjo këshillë është ende e saktë.

SË TRETË, Kosova duhet ta bëjë prioritet kryesor rindërtimin e besimit me Shtetet e Bashkuara, BE-në dhe NATO-n. Kjo është e rëndësishme sepse politika e jashtme e Kosovës nuk ka të bëjë më me zgjedhjen e drejtimit të saj, sepse vendi është qartësisht i përafuar me Perëndimin. Çështja e vërtetë është se, në momente kyçe, aleatët kryesorë të Kosovës nuk e kanë parë atë si të besueshme ose të parashikueshme. Kjo ka pasur pasoja reale. Në qershor 2023 SHBA-ja dhe BE-ja e paralajmëruan Kosovën që të tërhiqet në veri ose të përballet me pasoja. Në shtator 2025, Shtetet e Bashkuara e pezulluan dialogun strategjik të planifikuar me Kosovën për shkak të shqetësimeve se veprimet e qeverisë në detyrë i kishin rritur "tensionet dhe mungesën e stabilitetit".⁷⁰ Ndërkohë, NATO thotë se KFOR-i është ende reaguesi i tretë pas Policisë së Kosovës dhe EULEX-it, dhe se KFOR-i tani ka rreth 5,200 trupa nga 33 vende aleate dhe partnere. Ky është realiteti me të cilin përballet Kosova, se ajo ende varet nga mbështetja ushtarake dhe politike perëndimore si garanci kryesore e sigurië. Kjo nuk do të thotë se Kosova duhet të heqë dorë nga e drejta e saj për të marrë vendimet e veta. Kjo do të thotë se ato vendime janë më efektive kur koordinohen dhe shpjegohen qartë. Vetë Programi i Qeverisë 2021-2025 ka paraparë se politika e jashtme e Kosovës duhet të jetë "e parashikueshme". Qeveria e ardhshme duhet ta marrë seriozisht këtë dhe të ndjekë një rregull të thjeshtë për veriun dhe çështje të tjera të ndjeshme, pa surpriza për aleatët dhe pa veprime të mëdha pa koordinim paraprak dhe një vlerësim të qartë të ndikimit tek qytetarët.

SË KATËRTI, Kosova duhet ta vendosë në qendër të politikës së saj të jashtme dhe të sigurië krijimin e marrëdhënieve kontraktuale me NATO-n. Të gjithë të intervistuarit për këtë raport e mbështesin këtë pikëpamje. Një zyrtar i lartë publik e quan NATO-n "kornizën më kritike të sigurië" për Kosovën. Ish-zyrtari i lartë i sigurië dëshiron një rrugë më të qartë drejt NATO-s dhe bashkëpunim më të fortë në fushën e mbrojtjes dhe sigurië me partnerët kryesorë. Programi i Qeverisë gjithashtu zotohet për ngritjen e kapaciteteve të mbrojtjes sipas standardeve të NATO-s dhe për zgjerim të diplomacisë ushtarake dhe pjesëmarrjes në

69 Lexoni më shumë në: <https://tiranaobservatory.com/2021/03/26/kosovos-next-foreign-policy-a-wish-list/>

70 Lexoni më shumë në: https://xk.usembassy.gov/st_9122025/

operacionet ndërkombëtare nën mbikëqyrjen e NATO-s. Kjo tani duhet të bëhet një agjendë më serioze. Kosova duhet ta përmirësojë mënyrën si punojnë forcat e saj me NATO-n, të profesionalizojë Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK), të forcojë prokurimin dhe planifikimin, si dhe të zgjerojë trajnimin dhe arsimin me NATO-n. Gjithashtu duhet të jetë realiste që për sa kohë që KFOR-i është mbështetësi kryesor i sigurisë në Kosovë, modernizimi i mbrojtjes duhet t'i qetësojë aleatët, jo të ngrejë shqetësime të reja për përshkallëzim të mundshëm ose zinxhirë furnizimi. Kosova ka njoftuar planet për të ndërtuar një fabrikë municionesh me prodhuesin shtetëror turk të mbrojtjes MKE⁷¹, një laborator të projektimit të dronëve⁷² dhe për të rritur shpenzimet e mbrojtjes për 60 për qind.⁷³ Këto hapa kanë kuptim, por duhet të ndjekin standardet e NATO-s, transparencën dhe partneritetet e besueshme. E njëjta gjë vlen edhe për ruajtjen e paqes. Kosova duhet të kontribuojë më shumë në sigurinë ndërkombëtare përmes misioneve të NATO-s, dhe ish-zyrtari i lartë i sigurisë i intervistuar për këtë raport vuri në dukje se Kosova duhet të kalojë nga thjesht konsumatore e sigurisë në ofruese të saj. Por kjo duhet bërë me kujdes. Siç ka shkruar Visoka, projekte si Bordi i Paqes janë tërheqëse sepse Kosova është jashtë organizatave të mëdha ndërkombëtare, por ato gjithashtu kanë nevojë për qartësi ligjore, përgatitje politike dhe planifikim solid të mbrojtjes së forcës.⁷⁴

Kosova mund t'i përmirësojë marrëdhëniet e saj me NATO-n duke ndjekur dy hapa kryesorë. Së pari, duhet të punojë për t'u bërë partner sigurie më i besueshëm dhe i parashikueshëm. Së dyti, duhet të ndihmojë në krijimin e një mjedisi politik më të qëndrueshëm përmes progresit në normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë. Një raport i QKSS-së për marrëdhëniet Kosovë-NATO thekson se anëtarësimi i plotë është ende i bllokuar sepse katër vende të NATO-s nuk e njohin Kosovën.⁷⁵ Megjithatë, raporti thotë se kjo nuk e pengon Kosovën të ndërtojë bashkëpunim më të thellë. Ideja kryesore është që NATO të krijojë një model vetëm për Kosovën (siç bëri BE-ja me Marrëveshjen e Stabilizimit Asocimit-MSA) për

bashkëpunim të zgjeruar për të mundësuar një rrugë të veçantë partneriteti për vendin dhe për të lejuar më shumë trajnime, stërvitje të përbashkëta, bashkëpunim emergjent civil, edukim ushtarak, ndërveprueshmëri dhe ndërtim të institucioneve të mbrojtjes, të gjitha pa kërkuar që vendet mosnjohëse të ndryshojnë qëndrimin e tyre për shtetësinë e Kosovës. Pra, në vend që të presë që të gjithë të bien dakord për anëtarësimin, Kosova duhet të përqendrohet në bashkëpunim praktik që i bën normale lidhjet më të ngushta me NATO-n, të dobishme dhe më të lehta për t'u pranuar nga Aleanca, deri sa konteksti të lejojë anëtarësimin e plotë.

Me fjalë të tjera, Kosova nuk ka nevojë të presë konsensus të plotë për anëtarësimin për ta përmirësuar pozitën dhe marrëdhëniet e saj me NATO-n. Duke avancuar një model bashkëpunimi vetëm për Kosovën, vendi mund të ndërtojë një rekord të kontributeve praktike dhe ndërveprueshmërisë që tashmë mund të formësojë mënyrën si e sheh NATO Kosovën, si një partner të ngulitur në praktikën, vlerat dhe arkitekturën e sigurisë së NATO-s, të gatshëm për lidhje më të thella kur ta lejojë konteksti politik.

Samiti i NATO-s i planifikuar në Tiranë në vitin 2027 i jep Kosovës një hapje konkrete politike për të synuar hedhjen e një hapi përpara në marrëdhëniet me Aleancën, edhe nëse anëtarësimi i plotë mbetet i bllokuar, aktualisht.

Kalendari zyrtar i samiteve të NATO-s përfshin takime në aleatët kryesorë të Kosovës, me samit në Turqi në vitin 2026 dhe një samit të NATO-s në Tiranë në vitin 2027. Kosova nuk duhet të presë në formë pasive. Ajo mund të punojë paralelisht për të krijuar konsensus për anëtarësimin, si dhe për të nxitur një rrugë partneriteti specifike për Kosovën, që përfshin zgjerim të trajnimeve, stërvitjeve, ndërtim të institucioneve të mbrojtjes dhe ndërveprueshmëri praktike me NATO-n. Samiti i vitit 2027 mund të përdoret si një cak i fokusuar diplomatik dhe qeveria e Kosovës duhet të punojë me Shqipërinë, Shtetet e Bashkuara, Turqinë dhe aleatët e tjerë mbështetës për të siguruar të

71 Lexoni më shumë në: <https://www.dailysabah.com/business/defense/turkiye-to-build-ammunition-plant-in-kosovo-as-defense-links-grow>

72 Lexoni më shumë në: <https://www.reuters.com/business/aerospace-defense/kosovo-boost-defence-spending-by-60-plans-drone-ammunition-production-pm-says-2025-03-26/>

73 Lexoni më shumë në: <https://www.reuters.com/business/aerospace-defense/kosovo-boost-defence-spending-by-60-plans-drone-ammunition-production-pm-says-2025-03-26/>

74 Lexoni më shumë në: <https://kosovotwopointzero.com/en/kosovo-and-the-board-of-peace>

75 Lexoni më shumë në: https://qkss.org/images/uploads/files/Exploring_options_for_advancing_Kosovo-NATO_relations.pdf

paktën një sinjal politik, një paketë bashkëpunimi të përshtatur ose lansimin e diçkaje të veçantë për Kosovën që përfshin bashkëpunim të zgjeruar.

Një hapje praktike e mundshme për Kosovën është pjesëmarrja në Qendrat e Ekselencës të akredituara nga NATO, ku vendet partnere mund të bashkohen si partnerë kontribues dhe të kenë qasje në doktrinë, trajnime, mësim të nxjerra dhe ekspertizë të specializuar. Qendrat e Ekselencës janë institucione të vendosura mirë që e mbështesin Aleancën në fusha të tilla si kërcënimet hibride, kibernetike, gatishmëria civile dhe analiza strategjike. Paralelisht, Kosova duhet të kërkojë qasje të rregullt në Kolegjin e Mbrojtjes të NATO-s dhe Kolegjin Evropian të Sigurisë dhe Mbrojtjes, ku institucionet nga vendet e treta dhe kandidatet mund të aplikojnë si Partnerë të Asociuar të Rrjetit.

Kosova mund ta përdorë bashkëpunimin me Agjencinë Evropiane të Mbrojtjes (EDA) si një mënyrë praktike për t'iu bashkuar sistemit të mbrojtjes së BE-së, në vend që ta shohë atë si diçka të mundur vetëm pas anëtarësimit. BE-ja veç po shkon drejt rritjes së bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes me Ballkanin Perëndimor.

Siç thekson analiza e fundit nga EUISS, rritja e bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes midis BE-së dhe Ballkanit Perëndimor shihet si një mundësi kyçe për ta afruar rajonin me Unionin, veçanërisht tani që mbrojtja është fokus madhor në Evropë.⁷⁶ Ky ndryshim i jep Kosovës një shans për të punuar drejt integritit, edhe nëse nuk është ende anëtare e plotë e BE-së ose NATO-s. Vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor ofrojnë shembuj të dobishëm. BE-ja veç ka krijuar partneritete të sigurisë dhe mbrojtjes me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut, duke ua lejuar t'iu bashkohen projekteve të mbrojtjes së BE-së, të punojnë me EDA-n dhe të zhvillojnë kapacitete ushtarake së bashku. Analiza nga Carnegie Europe sugjeron se vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të investojnë në partneritete me anëtarët e BE-së për të modernizuar ushtritë e tyre dhe për t'iu integruar gradualisht në iniciativat e reja të mbrojtjes së unionit, duke treguar se integrimi mund të ndodhë hap pas hapi dhe përmes projekteve specifike, jo të gjitha menjëherë.⁷⁷

Për Kosovën, ky opsion mund të jetë si i nevojshëm ashtu edhe realist. Praktikisht, Kosova duhet të ketë një qasje hap pas hapi. Së pari, ajo duhet të sigurohet që qeverisja e saj e mbrojtjes, proceset e prokurimit dhe aftësia për të punuar me të tjerët të përputhen me standardet e BE-së. Më pas, Kosova mund t'iu bashkohet projekteve të mbështetura nga EDA ose të marrë pjesë si vëzhgues duke punuar me vendet anëtare të BE-së. Së fundi, ajo duhet ta lidhë me prioritetet e BE-së zhvillimin e saj të mbrojtjes, si për shembull në fusha si siguria kibernetike, reziliencia dhe industria e lehtë e mbrojtjes.

Prioriteti më i rëndësishëm i sigurisë së brendshme është një proces i strukturuar dhe i koordinuar i integritit në institucionet e Kosovës të serbëve të Kosovës, veçanërisht në veri, në një mënyrë që (1) përmirëson

jetën e përditshme, (2) zvogëlon hapësirën e shtrëngimit për akterët kriminelë dhe të huaj, dhe (3) sinkronizohet me dialogun e normalizimit të lehtësuar nga BE-ja dhe që nuk paraqitet si “fitore” të njëanshme. Një strategji e fortë integrimi duhet të përfshijë një dokument koncepti, siç është një libër i bardhë e qeverisë, i cili bazohet fort në parimet e Propozimit Gjithëpërfshirës të OKB-së për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës (Plani Ahtisaari).⁷⁸ Ky propozim u dizajnuar për të përmbushur nevojat e serbëve të Kosovës duke promovuar decentralizimin dhe të drejtat e komunitetit, duke u dhënë komunave me shumicë serbe më shumë kontroll dhe kompetenca më të forta. Ai gjithashtu përcaktoi marrëveshjet e sigurisë bazuar në një sektor profesional dhe multietnik të sigurisë me komandë të unifikuar dhe polici lokale që përputhet me përbërjen etnike të secilës komunë.

Kosova mund të paraqesë një “ofertë integrimi dhe stabilizimi” për veriun përmes një dokumenti koncepti që mbulon periudhën 2027-2030. Ky dokument do t'i kthejë në masa specifike të sekuencuara për zbatim në veri normat ligjore dhe kushtetuese të Kosovës si dhe obligimet nga dialogu i normalizimit. Çështja kryesore në veri nuk është vetëm kontesti politik, por edhe pasiguria e vazhdueshme në lidhje me

76 Lexoni më shumë në: <https://www.iss.europa.eu/sites/default/files/2026-02/2025-10%20BZ%20Western%20Balkans.pdf>

77 Lexoni më shumë në: <https://carnegieendowment.org/europe/strategic-europe/2025/10/how-the-western-balkans-can-contribute-to-european-defense>

78 Këshilli i Sigurimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Letër e datës 26 mars 2007 nga Sekretari i Përgjithshëm drejtuar Presidentit të Këshillit të Sigurimit (S/2007/168). Nju Jork: Kombet e Bashkuara, 2007. <https://www.securitycouncilreport.org/atf/cf/%7B65BFCE9B-6D27-4E9C-8CD3-CF6E4FF96FF9%7D/Kosovo%20S2007%20168.pdf>

parashikueshmërinë, legjitimitetin dhe koordinimin. Për të funksionuar mirë, dokumenti i konceptit duhet të fokusohet në katër fusha kryesore. Së pari, ai duhet të garantojë shërbime dhe të drejta praktike në përputhje me parimet e Planit Ahtisaari, duke përfshirë arsimin, kujdesin shëndetësor dhe mirëqenien sociale. Së dyti, dokumenti duhet të përfshijë një plan për ta forcuar besimin në polici dhe siguri në veri. Legjitimiteti është crucial dhe qeveria e Kosovës duhet të angazhohet për të siguruar që një serb i Kosovës të bëhet komandant i komandës rajonale të policisë për veriun dhe për të rritur numrin e zyrtarëve policorë nga komuniteti serb i Kosovës që shërbejnë në veri. Së treti, qeveria e Kosovës duhet të krijojë një grup punues për hartimin e statutit dhe aktin e themelimit të Asociacionit të Komunave me shumicë serbe. Dokumenti duhet gjithashtu të ofrojë një plan të qartë për kthimin e serbëve të Kosovës nga veriu në institucionet e tyre, duke e bërë më të lehtë, administrativisht, rikthimin e tyre pa u përballur me reagime sociale ose politike. Së katërti, dokumenti i konceptit duhet të kërkojë koordinim të ngushtë me BE-në dhe partnerët kyç të sigurisë. Vendimet madhore në veri duhet të ndjekin një proces të strukturuar dhe të shmangin përshkallëzimin ose pasojat e paqëllimshme.

Kosova duhet ta bëjë sigurinë kibernetike, mbrojtjen e infrastrukturës kritike dhe kërcënimet hibride pjesë qendrore të agjendës së saj të sigurisë kombëtare. Të intervistuarit për këtë raport dhe hulumtim pajtohen në këtë pikë. Siç theksohet nga zyrtarët e lartë qeveritarë të intervistuar për këtë raport, sigurisë kibernetike dhe energjetike duhet t'i jepet prioritet absolut. Në këtë kontekst, një prioritet tjetër i rëndësishëm i brendshëm është kryerja e një shqyrtimi të plotë dhe të besueshëm të sektorit të sigurisë, veçanërisht sistemit të policisë dhe të sigurisë publike. Ka kaluar kohë qëkur Kosova ka zbatuar një pasqyrë holistike të sektorit të sigurisë dhe sfidat e Kosovës sot kanë të bëjnë me mbajtjen e profesionalizmit, ndërtimin e besimit, përmirësimin e shërbimeve dhe forcimin e aftësisë së saj për ta luftuar krimin e organizuar dhe ndikimin e huaj.

Qeveria e Kosovës duhet të sigurojë që plani i tranzicionit të FSK-së të zbatohet plotësisht dhe në një mënyrë që nxit besueshmërinë me

partnerët, jo vetëm kapacitetet. Kosova duhet ta ketë prioritet përfundimin e planit të tranzicionit të Forcave të Sigurisë së Kosovës në një mënyrë që të ndërtojë besim me partnerët dhe të forcojë aftësinë frenuese. Fokusi mund të jetë një rrugë e dyfishtë për ngritjen e kapaciteteve, si dhe për përmirësimin e qeverisjes dhe përmbushjen e standardeve të NATO-s, sigurimin e transparencës së blerjeve dhe shtimin e kontrolleve të integritetit në planifikimin e mbrojtjes. Kosova gjithashtu duhet të fillojë shqyrtimin e "furnizuesve të besueshëm" të teknologjive të mbrojtjes dhe me përdorim të dyfishtë për të ulur risqet e varësisë dhe për të treguar pjekuri strategjike. Zhvillimi i mbrojtjes do të jetë i besueshëm vetëm nëse është i parashikueshëm, i koordinuar dhe sidomos në përputhje me pritjet e BE-së.

Kosova duhet të rimendojë qasjen e saj ndaj bashkëpunimit policor ndërkombëtar. Fokusi duhet të jetë në mbylljen e hendekëve realë të sigurisë, jo vetëm në përfshirjen simbolike. Në praktikë, bashkëpunimi me Europol-in është rritur përmes shkëmbimeve të SIENA, operacioneve të përbashkëta dhe të pasurit oficerë ndërlidhës. Megjithatë, ai është ende e kufizuar nga Aranzhimi Punues aktual, i cili nuk lejon ndarjen e të dhënave personale. Siç theksohet në memorandumun e politikave të QKSS-së, "bashkëpunimi operacional veç po ndodh, por korniza ligjore nuk e ka arritur ende".⁷⁹ Ky hendek është i rëndësishëm. Pa një bazë më të fortë ligjore, Kosova është i vetmi vend i Ballkanit Perëndimor jashtë kornizës operacionale të Europol-it. Kjo e bën më të vështirë luftën kundër krimin të organizuar, trafikimit dhe kërcënimeve ndërkufitare. Kosova duhet ta bëjë prioritet finalizimin e një Marrëveshje Operacionale duke përditësuar ligjet e saj për mbrojtjen e të dhënave për t'iu përshtatur standardeve të BE-së dhe duke treguar se është e gatshme për shkëmbim të sigurt të të dhënave. **Kosova duhet ta shohë anëtarësimin në INTERPOL si një synim afatgjatë që mbështet kapacitetet e saj të përgjithshme.** Të mos qenurit anëtar kufizon bashkëpunimin në kohë reale dhe do të thotë të varesh nga kanale më të ngadalta dypalëshe, çka e dobëson zbatimin e ligjit. Një strategji e fortë duhet të përziejë ndërtimin e aleancave me hapa praktikë si përmirësimi i gatishmërisë institucionale, zgjerimi i bashkëpunimit policor me vendet e tjera dhe tregimi i kontributeve

79 Lexoni më shumë në: <https://qkss.org/al/publikimet/policy-memo-why-is-kosovo-still-outside-europols-operational-framework>

të qëndrueshme në sigurinë rajonale.

Politika e jashtme e Kosovës gjithashtu duhet të bëhet më e larmishme, praktike dhe e fokusuar në rezultate. Kur kemi të bëjmë me vendet e BE-së që nuk e njohin Kosovën, nevojitet një qasje e përshtatur. Teksa fitimi i njohjes duhet të mbetet si synim, Kosova mund të ndërtojë marrëdhënie të forta pune, të ngjashme me “modelin grek”, përmes tregtisë, shkëmbimeve kulturore dhe angazhimit të rregullt, me mbështetjen e shoqërisë civile dhe grupeve akademike. Në organizatat ndërkombëtare, derisa Kosova duhet ta mbajë gjithmonë si synim përfundimtar anëtarësimin e plotë në OKB, në këtë fazë ajo duhet ta prioritetizojë sigurimin e të paktën statusit të vëzhguesit në OKB, si dhe të punojë për t’u anëtarësuar në agjencitë e OKB-së (d.m.th. UNESCO) dhe organet teknike. Meqenëse statusi i Vëzhguesit të Përhershëm për shtetet jepet nga Asambleja e Përgjithshme, kjo është potencialisht e arritshme për Kosovën. Kosova gjithashtu duhet të kërkojë të zgjerojë lidhjet e saj ekonomike dhe strategjike, veçanërisht me vendet e Gjirit, duke inkurajuar investime transparente, duke përmirësuar sigurinë energjetike dhe duke zhvilluar infrastrukturën. Një strategji e qartë për Azinë është gjithashtu e rëndësishme, duke u fokusuar në teknologji dhe zinxhirë të sigurt të furnizimit, veçanërisht me partnerë si Tajvani. Kosova duhet ta shohë dialogun ndërfetar dhe mbrojtjen e komuniteteve jo-shumicë jo vetëm si detyra lokale, por si pika të forta që rrisin stabilitetin brenda vendit dhe reputacionin e tij jashtë. Në këtë kontekst, Ministria e Punëve të Jashtme duhet ta kthejë konferencën vjetore për dialogun ndërfetar.

Lista të tjera të rëndësishme të detyrave të Kosovës në aspektin e politikës së jashtme dhe të sigurisë duhet të përfshijnë zhvillimin e një strategjie më të qartë për njohjet,

anëtarësimin në organizatat ndërkombëtare dhe diversifikimin e diplomacisë së saj, sepse njohja është ende politike, e kushtueshme dhe e nevojshme. Të intervistuarit për këtë raport theksojnë se Kosova duhet të jetë më selektive dhe strategjike. Një zyrtar i lartë publik thekson nevojën për njohje nga pesë vendet anëtare të BE-së që ende nuk e kanë njohur Kosovën. Zyrtari i lartë i qeverisë thotë se Kosova duhet të përqendrohet në organizata ku anëtarësimi sjell përfitime reale, si Këshilli i Evropës, BE-ja dhe INTERPOL, në vend që t’i shpërndajë resurset e saj të kufizuara diplomatike. Në të njëjtën kohë, Kosova duhet të zgjerojë bashkëpunimin përtej partnerëve të saj të zakonshëm, siç sugjeron zyrtari i lartë i qeverisë, duke ndërtuar lidhje më të forta me vende si Japonia, vendet Balltike, Nordikët dhe fuqitë e tjera të mesme, dhe duke përmirësuar stafin në ambasadat kyçe. **Kosova duhet të krijojë një strategji formale të politikës së jashtme dhe të sigurisë dhe të sigurohet që të gjitha institucionet të koordinohen, sepse mungesa e koordinimit tani ka kosto reale të jashtme.** Kjo është e qartë nga intervista me ish-zyrtarin e lartë të sigurisë, i cili paralajmëron se koordinimi i dobët midis Presidencës dhe Qeverisë ka çuar në mesazhe të përziera për partnerët ndërkombëtarë, ka dëmtuar besueshmërinë dhe madje ka shkaktuar probleme gjatë masave kufizuese të BE-së dhe pezullimit të dialogut strategjik me Shtetet e Bashkuara. Për një vend të vogël si Kosova me pak hapësirë për gabime, mungesa e koordinimit bëhet shpejt risk i madh. Qeveria e ardhshme duhet të punojë me Kuvendin dhe të miratojë një strategji formale të politikës së jashtme dhe të sigurisë që përcakton prioritetet, rendin e veprimeve, rregullat e koordinimit dhe komunikimin e qartë, të cilat sigurojnë qëndrueshmëri dhe parashikueshmëri përtej cikleve politike.

7. KONKLUZIONE

Nga viti 2021 deri në vitin 2025, politika e jashtme dhe e sigurisë së Kosovës u përcaktua nga një lloj paradoksi, sepse, derisa orientimi i vendit mbeti i qartë, aftësia e tij për ta kthyer atë orientim në përfitime konkrete u kufizua nga krizat e brendshme dhe pamundësia për kompromis ndërmjet partive politike për formimin e institucioneve, dhe një qasje mjaft antagoniste ndaj parimit të koordinimit dhe konsultimit me SHBA-në dhe BE-në për çështjet që lidhen me dialogun e normalizimit me Serbinë dhe në veri të vendit. Veriu i Kosovës u bë zona qendrore ku kanë konverguar pothuajse të gjitha presionet kryesore. Kontestimi i vazhdueshëm i Serbisë për shtetësinë e Kosovës, risqet e sigurisë, krimi i organizuar, tensionet ndëretnike, pritjet e aleatëve dhe besueshmëria ndërkombëtare e Kosovës. Në të njëjtën kohë, kërcënimet më të reja si sabotimi i infrastrukturës kritike, manipulimi i huaj i informacionit dhe presioni hibrid treguan se mjedisi i sigurisë në Kosovë është më i gjerë, më kompleks dhe më kërkues se më parë.

Raporti gjithashtu tregon se Kosova nuk qëndroi në vend. Ajo bëri disa përparime me hyrjen në fuqi të liberalizimit të vizave në vitin 2024, përafrimin e plotë me pozicionet perëndimore për çështjet kryesore gjeopolitike, bashkëpunimin më të thellë me NATO-n dhe Europol-in, rritjen e investimeve në mbrojtje dhe njohjet e reja. Por këto përfitime shpesh janë zbehur nga ngërçi i brendshëm politik, koordinimi i dobët ndërinstitucional, planifikimi i pamjaftueshëm dhe fërkimet e shmangshme me BE-në dhe Shtetet e Bashkuara. E vërteta e hidhur është se Kosova nuk humbet terren vetëm për shkak të Serbisë, Rusisë, Kinës, apo limiteve të sistemit ndërkombëtar. Ajo humbet terren edhe kur lejon që krizat të lënë në hije prioritetet dhe nuk arrin të veprojë si partner i disiplinuar, i parashikueshëm dhe i koordinuar mirë.

Për këtë arsye, mësimi qendror për politikën nuk ka të bëjë me nevojën për një orientim/qasje të re të politikës së jashtme dhe të sigurisë, por se Kosova duhet ta zbatojë më seriozisht drejtimin e saj ekzistues. Kjo do të thotë të trajtohet veriu jo vetëm si çështje e zbatimit të ligjit, por si një sfidë për qeverisjen, legjitimitetin dhe përfshirjen. Kjo do të thotë edhe që normalizimit me Serbinë duhet t'i qaset si prioritet për konsolidimin e shtetit dhe jo si menaxhim i përhershëm i krizave. Kjo do të thotë të rindërtohet besimi me BE-në, NATO-n dhe Shtetet e Bashkuara përmes koordinimit më të mirë dhe më pak surprizave. Do të thotë gjithashtu që në agjendën e sigurisë të vendoset shumë më lart rezilienca kundër kërcënimeve kibernetike, infrastrukturës kritike dhe FIMI. Drejtimi i Kosovës nuk është në diskutim. Çka është në pyetje është nëse ajo mund të veprojë me konsistencën, pjekurinë dhe disiplinën e kërkuar dhe të nevojshme për ta shndërruar përafrimin e saj të fortë perëndimor në siguri, shtetësi më të fortë dhe integrim më të thellë ndërkombëtar.

Kjo ka më shumë rëndësi në kontekstin aktual global, të karakterizuar nga paparashikueshmëria, multipolariteti i thyer dhe linjat e paqarta. Për një vend si Kosova, përafrimi me Perëndimin mbetet e vetmja pikë ankorimi serioze gjeopolitike. Megjithatë, nuk është më gjithmonë e qartë se çfarë kërkon ky përafrim në praktikë kur Shtetet e Bashkuara dhe BE-ja nuk e interpretojnë gjithmonë të njëjtën situatë në të njëjtën mënyrë. Polemika rreth vendimit të Kosovës për t'iu bashkuar "Bordit të Paqes" të Presidentit Trump e ilustron mirë këtë. Për Kosovën, kjo lëvizje mund të shihet si demonstrim i afërsisë me Perëndimin dhe Uashingtonin.⁸⁰ Megjithatë, shumica e vendeve anëtare të BE-së e refuzuan ftesën për të qenë pjesë e kësaj iniciative. Kjo tregon se në një Perëndim më pak koherent, gjestet simbolike të besnikërisë mund të prodhojnë efekte të përziëra. Për Kosovën, implikimi mund të jetë se politika e jashtme dhe e sigurisë tani duhet të jetë më e disiplinuar, e sekuencuar me kujdes dhe e kalibruar politikisht. Të qenurit pro-perëndimor nuk ka të bëjë më vetëm me qëndrimin në anën e duhur, por edhe me gjetjen e rrugës mes pritjeve konkurruese brenda vetë Perëndimit.

80 Lexoni më shumë në: <https://kosovotwopointzero.com/en/kosovo-and-the-board-of-peace>

SFIDAT DHE PRIORITETET E KOSOVËS NË FUSHËN E POLITIKËS SË JASHTME DHE TË SIGURISË

PUBLIKUAR NGA::

© Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS)

© Konrad-Adenauer-Stiftung (KAS)

AUTORË:

Ramadan Ilazi

MIRËNJOHJE:

Autori dëshiron të falënderojë Asllan Zenunajn për kontributin e tij në këtë raport.

DIZAJNI DHE PARAQITJA NGA:

Brand Vision Shpk

Kontakti: +383 45 559 923

Email: brandvision.rks@gmail.com

© The views expressed in this paper are those of the authors and do not necessarily reflect the views of Konrad-Adenauer-Stiftung. The publication is solely intended for information purposes. It may not be used by political parties or by election campaigners or supporters for the purpose of election advertising.



QKSS
Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

**KONRAD
ADENAUER
STIFTUNG**

Rreth QKSS

E themeluar në prill 2008, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) është organizatë e specializuar, e pavarur dhe joqeveritare. Qëllimi kryesor i QKSS-së është të promovojë demokratizimin e sektorit të sigurisë në Kosovë dhe të përmirësojë punën hulumtuese dhe të avokimit në lidhje me sigurinë, sundimin e ligjit dhe bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar në fushën e sigurisë.

QKSS synon të rrisë efektivitetin e Reformës së Sektorit të Sigurisë (RSS) duke mbështetur programet RSS nëpërmjet hulumtimeve, ngjarjeve, trajnimeve, avokimeve dhe këshillave të drejtpërdrejta të politikës.

Avancimi i ideve të reja dhe metodave të shkencave sociale janë gjithashtu vlerat thelbësore të qendrës. Çdo vit, QKSS publikon një numër të madh të raporteve, dokumente të politikave dhe dokumente të shkurtra të politikave. Gjithashtu, organizon më shumë se 200 evente publike duke përfshirë konferenca, tryeza të rrumbullakëta, debate dhe ligjërata në Kosovë, dhe në bashkëpunim me partnerët regional dhe ndërkombëtar.

Një sferë e gjerë e aktiviteteve përfshijnë hulumtimet, ndërtimin e kapaciteteve, ndërgjegjësimin dhe avokimin. Puna e QKSS mbulon një gamë të gjerë temash, duke përfshirë, por pa u kufizuar në reformën dhe zhvillimin e sektorit të sigurisë; identifikimin dhe analizimin e risqeve të sigurisë që lidhen me ekstremizmin, radikalizmin dhe krimin e organizuar; politikën e jashtme dhe bashkëpunimin rajonal; dhe vlerësimin e sundimit të ligjit në Kosovë.

Rreth KAS

Konrad-Adenauer-Stiftung është fondacion politik gjerman që u zhvillua nga Shoqata për Punën Edukative Demokristiane, e themeluar në vitin 1955. Prej vitit 1964, mban emrin e Kancelarit të parë Federal, Konrad Adenauer. Ne ndihemi të lidhur me kujtesën dhe trashëgiminë politike të Adenauer; parimet e tij shërbejnë si udhëzime, mision dhe përkushtim për ne. Prandaj, jemi të lidhur politikisht me Unionin Kristian Demokrat të Gjermanisë, por jemi të pavarur financiarisht dhe organizativisht.

Promovimi i demokracisë liberale dhe një ekonomie sociale të tregut, i paqes dhe lirisë, marrëdhënive transatlantike dhe unifikimit evropian - kjo është çka e përfaqëson Konrad-Adenauer-Stiftung.

Edhe pse puna në Kosovë filloi shumë më herët përmes projekteve të ndryshme, KAS u regjistrua zyrtarisht në Prishtinë në qershor 2007. Prej atëherë, KAS është fokusuar në edukimin politik, edukimin qytetar dhe forcimin e shoqërisë civile, integrimin evropian, mbështetjen e dialogut ndëretnik dhe ndërfetar, promovimin e ekonomisë së tregut të lirë dhe tema të tjera, të cilat së bashku me partnerët tanë lokal dhe ndërkombëtarë, i kemi trajtuar përmes seminareve, konferencave, diskutimeve dhe botimeve të shumta.



qkss.org
securitybarometer.qkss.org



ISBN 978-9951-842-58-7



9 789951 842587